




KONFLIKTI I INTERESIT NË AVANCIME DHE PËRFITIME NË KËSHILLIN GJYQËSOR DHE PROKURORIAL



Autor: Lavdim Bajraktari

Ekipi redaktues: Betim Musliu, Ehat Miftaraj, Gzim Shala dhe Yll Zekaj

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e Byrosë së Narkotikëve Ndërkombëtar dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) - Departamenti i Shtetit Amerikan dhe NED-it.

Ky botim është produkt i projektit “Kërko Drejtësi: Fuqizimi i qasjes në drejtësi në Kosovë”, i cili mbështetet nga Departamenti i Shtetit Amerikan përmes Byrosë Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) dhe zbatohet nga Instituti i Kosovës për Drejtësi - IKD në partneritet me Iniciativa për Progres - INPO.

RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD

Rr. Rrustem Statovci

Prishtinë

E: info@kli-ks.org

www.kli-ks.org

Përkrahur nga:

Prill, 2021

Prishtinë, Republika e Kosovës



**National Endowment
for Democracy**
Supporting freedom around the world

PËRMBAJTJA

1. Përmbledhje ekzekutive.....	4
2. Metodologjia.....	6
3. Korniza ligjore e ndalimit të shtesave dhe funksioneve të shumëfishta	7
4. Mandati ligjor dhe funksioni i KGJK-së	10
5. Anëtarët e KGJK-së dhe pagat e tyre	11
a) Përbërja e KGJK-së	11
b) Pagat e anëtarëve të KGJK-së	12
c) Normimi i kundërligjshëm i shtesave në KGJK	12
6. Shtesat dhe funksionet e anëtarëve të KGJK-së.....	14
7. Mandati ligjor dhe funksioni i KPK-së	23
8. Anëtarët e KPK-së dhe pagat e tyre	24
a) Përbërja e KPK-së	24
b) Pagat e anëtarëve në KPK	24
9. Shtesat dhe funksionet e anëtarëve të KPK-së.....	25
10. Rekomandime.....	37

1. Përmbledhje ekzekutive

Ligje të mira në letër, e zbatim i dobët ose mos zbatim fare i tyre në praktikë, është një histori që e ka përcjellë shtetin e Kosovës tash e sa kohë. Një ndër ligjet më të avancuara që është miratuar në Kosovë, është Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik. Ndonëse janë bërë gati tre vite që nga miratimi i këtij ligji, zbatimi i tij në praktikë mbetet i mangët. Madje, ndër shkelësit kryesor të tij po del të jenë pikërisht ata që janë të mandatuar për mbrojtjen e ligjshmërisë - prokurorët dhe gjyqtarët.

Krerë të sistemit të drejtësisë në Kosovë, kanë vazhduar të mbajnë nga dy (2), tre (3) apo deri gjashtë (6) pozita njëkohësisht dhe për të njëjtat të marrin edhe mijëra euro shtesa, krahas pagave të majme që të njëjtit kanë.

Sipas deklarimeve të pasurisë, 76% e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, kanë deklaruar se në kundërshtim me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit kanë pranuar shtesa të ndryshme nga burimet e ndryshme, përveç pagave të tyre bazë. Këto shtesa, anëtarët në fjalë i kishin marrë për punë që rëndom i kanë kryer gjatë orarit të tyre të rregullt të punës.

Gjithashtu, anëtarë të KGJK-së, kishin vazhduar të ushtrojnë edhe detyra tjera publike për të cilat janë shpërblyer me pagesë, ndonëse edhe Ligji për KGJK,

ia ndalon kryesuesit dhe anëtarëve të KGJK-së të ushtrojnë ndonjë detyrë tjetër publike apo profesionale për të cilën shpërblehen me pagesë.

Madje, KGJK ka nxjerrë edhe rregullore ku anëtarëve të vet që janë gjyqtarë me orar jo të plotë, u garanton shtesa krahas pagës së tyre bazë. Ky normim i shtesave të kundërligjshme, bie ndesh edhe me vet Ligjin për KGJK i cili parasheh kompensim vetëm për anëtarët jo-gjyqtarë të KGJK-së që nuk janë me orar të plotë.

Ngjashëm situata paraqitet edhe në Këshillin Prokurorial të Kosovës (KPK). Nga 18 anëtarë e ish-anëtarë të KPK-së të cilët janë analizuar për këtë raport, del se 72% apo 13 prej tyre kanë deklaruar se kanë pranuar shtesa e kompensime të ndryshme, krahas pagave bazë, sipas deklarimeve të tyre të pasurisë. Edhe anëtarët e këtij Këshilli, këto shtesa – që në disa raste arrijnë deri në mijëra euro, i kanë marrë në kundërshtim me ligjin dhe për punë e detyra që i kanë kryer gjatë orarit të rregullt të punës.

Përveç mbajtjes së funksioneve të shumëfishta dhe pranimit të shtesave të ndryshme - në pjesën më të madhe të tyre të kundërligjshme - anëtarë të KGJK-së dhe KPK-së kishin shpërfillur edhe dispozitat tjera të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Gjyqtari Armend Berisha, kishte kandiduar dhe pastaj ishte zgjedhur kryetar i Gjykatës Themelore në Pejë, vetëm rreth tetë (8) muaj pasi kishte dhënë dorëheqje nga pozita e anëtarit në KGJK. Një gjë të tillë ishte bërë në kundërshtim me ligjin për parandalimin e konfliktit të interesit.

Njëjtë kishte vepruar edhe ish-anëtarja e KPK-së, Dëshirë Jusaj, por për dallim nga gjyqtari Berisha, e njëjta nuk kishte arritur të zgjidhej kryeprokurore e Gjakovës. Pasi konkursi i parë për kryeprokuror të Gjakovës kishte dështuar, prokurorja Jusaj sërish kishte kandiduar për kryeprokurore në konkursin e ri-shpallur dhe kjo kandidaturë e saj kundërligjshëm është konfirmuar nga KPK.

Në mënyrë të kundërligjshëm ishte avancuar në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit edhe prokurori Bahri Hyseni, vetëm disa javë pasi të njëjtit i kishte skaduar mandati si kryesues në KPK. Hyseni ishte transferuar në ZKSH, me një vendim të kryeprokurorit të shtetit, Aleksandër Lumezi. Ky i fundit, edhe gjatë vitit 2020, përveç pozitës së kryeprokurorit të shtetit, kishte vazhduar të mbajë edhe dy pozita tjera udhëheqëse, duke vepruar kështu në kundërshtim me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Një pjesë e anëtarëve të të dy Këshillave, kanë deklaruar të hyrat e tyre duke mos i ndarë ato sipas shumës, llojit apo burimit të të hyrave, por duke

i paraqitur të gjitha së bashku. Në këtë mënyrë, të njëjtit nuk kanë deklaruar të ardhurat në përputhje me Ligjin për Deklarimin e Pasurisë, dhe rrjedhimisht ia kanë pamundësuar publikut të dijë se sa nga të ardhurat e tyre kanë qenë pagë e sa të tjera, shtesa, mëditje apo kompensime.

2. Metodologjia

Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) me qëllim që të përpilojë një raport sa më gjithëpërfshirës dhe analitik në lidhje me veprimtarinë profesionale, sjelljen dhe shpërblimet monetare të anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), ka përdorur një metodologji të përzier të hulumtimit.

Ky raport i IKD-së është bazuar në të dhënat e siguruara nga dokumente të ndryshme zyrtare, legjislacion primar dhe sekondar, raporte zyrtare të KGJK-së dhe KPK-së, si dhe të dhënat të siguruara përmes kërkesave për informata dhe qasje në dokumente zyrtare nga institucionet relevante.

Para së gjithash, ky raport është derivat i monitorimit sistematik që IKD i bënë sistemit gjyqësor, duke përfshirë këtu edhe punën e KGJK-së dhe KPK-së.

Për qëllime të këtij hulumtimi, IKD ka analizuar edhe deklarimet e pasurisë të të gjithë anëtarëve të KGJK-së dhe KPK-së si dhe të ish-anëtarëve të këtyre Këshillave gjatë viteve 2019 dhe 2020. Po ashtu, për hartimin e një raporti sa më të saktë dhe objektiv, IKD ka realizuar edhe intervista me anëtarë të të dy (2) Këshillave.

Gjetjet e IKD-së janë trajtuar me anë të analizës së kornizës ligjore, krahasimit të rasteve dhe vendimeve, punës me të dhëna statistikore dhe analizimit të

thukhtë të çdo veprimi apo vendimi nga sistemi i drejtësisë përkitazi me pajtueshmërinë e tyre me legjislacionin në fuqi.

Ky raport, për sa i përket të të ardhurave, bazohet në të dhënat e paraqitura nga vet anëtarët e KGJK-së dhe KPK-së në deklarimin e pasurisë që të njëjtit e kanë bërë në vitin 2020.

3. Korniza ligjore e ndalimit të shtesave dhe funksioneve të shumëfishta

Me qëllim të forcimit të integritetit të sektorit publik dhe garantimit të kryerjes së detyrave publike në mënyrë objektive, të paanshme dhe transparente në shërbim të interesit publik, Kuvendi i Kosovës, në vitin 2018 kishte miratuar **Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Funksionin Publik**.¹

Ndër të tjera, me këtë ligj ishin përcaktuar edhe parimet, rregullat dhe procedurat, për ato sjellje që u ndalohen zyrtarëve gjatë kryerjes së detyrave publike, por edhe masat ndaj atyre që shkelin dispozitat e caktuara në këtë ligj.

Një dukuri që ka qenë, dhe fatkeqësisht, ende mbetet e përhapur tek zyrtarët në Kosovë, ajo e mbajtjes së pozitive të shumëfishta, nga të cilat pastaj rrjedhin si pasojë edhe shtesat e shumëfishta, ishte synuar të eliminohej me miratimin e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Ky ligj, në nenet 12 dhe 13 të tij ka përcaktuar ndalesa të qarta për zyrtarët publik, për ushtrimin e funksioneve të tjera krahas funksioneve publike si dhe

papajtueshmërinë gjatë ushtrimit të funksionit publik nga zyrtarët.

Sipas nenit 12 të këtij ligji, zyrtarëve të lartë u ndalohet të ushtrojnë veprimtari të tjera sikurse ato të avokatit, noterit, përmbaruesit privat, administratorit të falimentimit, konsulentit dhe të tjera veprimtari për të cilat kërkohet licencim sipas ligjit.

Kurse, neni 13 (2) i Ligjit të lartcekur, kishte përcaktuar në mënyrë eksplicite se zyrtarët e lartë nuk mund të kenë **më shumë se sa një pozitë drejtuese** në institucione dhe organe publike, përveç kur shprehimisht kërkohet me ligj. Por, edhe në këto raste, sipas këtij neni, zyrtarët **nuk kanë të drejtë që për këto funksione të pranojnë shpërblime me pagesë**, përveç kompensimeve të shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimeve të tjera të lidhura me të².

Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, ministri i atëhershëm i Drejtësisë, Abelard Tahiri, si sponsorizues i ligjit, kishte thënë për "Betimi për Drejtësi" se me anë të këtij ligji do të stopohet praktika e "supermenëve" që mbajnë shumë pozita si dhe buxhetit të shtetit do t'i kursehen miliona euro nga shtesat e ndryshme që ishin paguar zyrtarët.³

¹ Ligji nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik. (Shih linkun <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=16314>) (qasur për herë të fundit më 9 prill 2021).

² Po aty. Neni 13.2..

³ "Intervistë: Abelard Tahiri". Betimi për drejtësi. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/emisionet/interviste-abelard-tahiri-2/>). Qasur për herë të fundit më 1 mars 2021.

Po ashtu, lidhur me këtë, në një intervistë për “Betimi për Drejtësi”, ushtruesi i detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Drejtësisë, Ardian Bajraktari, kishte thënë se dispozitat e këtij ligjit, për ta si sponsorizues të ligjit janë të qarta dhe eksplicite kur ndalojnë ushtrimin e më shumë se sa një pozite udhëheqëse krahas ushtrimit dhe funksionit të lartë publik, përjashtimisht rasteve kur në mënyre eksplicite parashihet me ligj, dhe se po ashtu, sipas tij, në mënyrën eksplicite ligji ndalon edhe kompensimin për angazhime gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare edhe angazhimin në ndonjë komision tjetër, përjashtimisht çështjes kompensimit që ndërlidhen me shpenzimet e udhëtimeve dhe shpenzimeve tjera që siç mund të jenë dreka ose të ngjashme.⁴

Në anën tjetër, Ligji për Gjykatat dhe ai për Prokurorin e Shtetit, ua lejojnë gjyqtarëve, gjegjësisht prokurorëve, që të marrin pjesë edhe në organizata profesionale apo takime shkencore që promovojnë pavarësinë dhe mbrojtjen e interesave të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Po ashtu, ligjet në fjalë u lejojnë gjyqtarëve dhe prokurorëve edhe angazhimin në veprimtari të tjera

që janë në përputhje me Kodet e Etikës dhe Sjelljes Profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve, por, këto veprimtari duhet të jenë jashtë orarit të punës dhe për to, nevojitet aprovimi paraprak nga kryetarët e gjykatave/kryeprokurorët apo aprovimi nga KGJK/KPK, në rastin e kryetarëve të gjykatave dhe kryeprokurorëve. Gjithsesi, për këto aktivitete që lejohen sipas këtyre ligjeve, gjyqtarët dhe prokurorët, nuk mund të pranojnë shpërblime që tejkalojnë vlerën prej 25% të pagës bazë.⁵⁶

Kushtetuta e Kosovës ka përcaktuar edhe standarde strikte për sa i përket papajtueshmërisë së ushtrimit të funksioneve të tjera nga ana e gjyqtarëve. Siç përcaktohet në Kushtetutë, “Gjyqtari *nuk mund të ushtrojë ndonjë funksion në institucionet shtetërore jashtë gjyqësorit, të jetë i përfshirë në ndonjë aktivitet politik ose ndonjë aktivitet tjetër të ndaluar me ligj*”.⁷ Pra, sipas kësaj dispozite kushtetuese, mes tjerash, një gjyqtar nuk mundet të ushtrojë asnjë funksion në institucione tjera shtetërore, po qe se ato institucione shtetërore nuk hyjnë nën ombrellën e pushtetit gjyqësor.

Mirëpo, pavarësisht ndalesave të përcaktuara në Ligjin për Parandalimin

⁴ “Abuzimet me pozita dhe shtesa në kundërshtim me ligjin”. Betimi për Drejtësi. 27 shkurt 2021. (Shih linkun: <https://www.youtube.com/watch?v=rjRfDXGMO-I>). Qasur për herën e fundit më 2 mars 2021.

⁵ Ligji nr. 06/L - 054 për Gjykatat. Neni 38.

⁶ Ligji nr. 06/L-025 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-034. Neni 25.

⁷ Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Neni 106 (1).

e Konfliktit të Interesit, gjyqtarë e prokurorë kanë vazhduar të mbajnë më shumë se sa një pozitë drejtuese apo edhe të pranojnë shtesa e mëditje në vlera që shkojnë deri në mijëra euro.

Krejt këtë, gjyqtarët dhe prokurorët e kishin bërë duke u thirrur në ligje të caktuara të cilat ishin nxjerrë para se të hynte në fuqi Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Kësisoj, gjyqtarë e prokurorë, krahas pagave të tyre bazë të cilat i marrin, kanë vazhduar që të marrin edhe shtesa, që në disa raste arrijnë vlera prej mijëra eurove, për punë që ata i kryejnë brenda orarit të tyre të rregullt të punës.

Mos zbatimit të këtij ligji duket se i ka kontribuar edhe mos veprimi i Agjencisë Kundër Korrupsionit (AKK). Kjo Agjenci kishte nxjerrë një opinion ligjor sipas të cilës, fakti se kryeprokurori i shtetit Aleksandër Lumezi mbante shtatë (7) pozita, prej të cilave edhe dy (2) pozita udhëheqëse të cilat nuk kërkoheshin me ligj, nuk përbënte konflikt të interesit. Gjithashtu, nga AKK e kishin vlerësuar problematike edhe çështjen e ndalesave të shpërblimeve me pagesë sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.⁸⁸

⁸⁸ "Abuzimet me pozita dhe shtesa në kundërshtim me ligjin". Betimi për Drejtësi. 27 shkurt 2021 (Shih [linkun: https://betimiperdrejtesi.com/emisionet/abu](https://betimiperdrejtesi.com/emisionet/abu)

Nisur nga qasja që AKK dhe zyrtarët e lartë kishin lidhur me interpretimin dhe zbatimin e ligjit, më 24 mars 2021, IKD i ishte drejtuar ministres së re të Drejtësisë, Albulena Haxhiu, me një shkresë, në të cilën i ishin ofruar hulumtimet dhe analizat e IKD-së, në lidhje me moszbatimin e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit. IKD kishte kërkuar nga ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu që në kuadër të mandatit të saj, të ndërmerr veprime konkrete në drejtim të Agjencisë Kundër Korrupsionit për të sqaruar dilemat dhe për të zbatuar drejtë Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit. Një ditë më pas, më 25 mars 2021, ministrja Haxhiu i ishte drejtuar me një opinion ligjor AKK-së, duke sqaruar se qëllimi parësor i këtij opinion ligjor është lehtësimi i zbatimit në praktikë të këtij ligji, në pajtim me frymën dhe qëllimin për të cilin ky ligj është miratuar.

Ministrja Haxhiu përmes këtij opinion ligjor, kishte sqaruar AKK-në se kufizimet e përcaktuara në nenin 12 dhe 13 të këtij ligji duhet të evitohen në praktikë rastet e ushtrimit të funksioneve publike në kundërshtim me frymën e ligjit dhe neneve të lartpërmendura përmes të cilave do të cenohet parimi i efikasitetit, profesionalizmit, integriteti personal i

[zimet-me-pozita-dhe-shtesa-ne-kundershtim-me-ligjin/](#)). Qasur për herën e fundit më 26 mars 2021.

zyrtarit publik dhe institucionit që përfaqëson.

Ministrja në këtë opinion, ka sqaruar nenin 13 të këtij ligji, duke theksuar se zyrtari i lartë, krahas funksionit të tij publik, mund të jetë anëtar i vetëm një organi të cekur më lartë, përveç nëse parashihet ndryshe shprehimisht me ligj. Sa i përket shpërblimeve me pagesë, ministrja kishte theksuar se qëllimi i dispozitës së nenit 13 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, është që zyrtarit të lartë t'i ndalohet shpërblimi me pagesë, dhe në anën tjetër t'i mundësohet vetëm kompensimi i shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimeve tjera të ndërlidhura me të.⁹

Në anën tjetër, një pjesë e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor dhe atij Prokurorial, kanë deklaruar se kanë pranuar kompensime të ndryshme, porse siç shihet nga këto deklaramë dhe shumat e tyre, të njëjtat del se janë në përputhje me kompensimet për udhëtime dhe kompensime tjera që lidhen me to, ashtu siç e parasheh edhe Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

⁹ "Ministrja Haxhiu i drejtohet me opinion ligjor AKK-së: Zbatoheni drejtë Ligjin për Konflikt të Interesit, ndalni "supermenët" dhe ndalni shpërblimet me pagesë për shtesa". Betimi për Drejtësi. 25 mars 2021. (Shih linkun: https://betimiperdrejtesi.com/ministrja-haxhiu-i-drejtohet-me-opinion-ligjor-akk-se-zbatoheni-drejte-ligjin-per-konflikt-te-interesit-ndalni-supermenet-dhe-ndalni-shperblimet-me-pagese-per-shtesa/?fbclid=IwAR2LoxcVUVj_vJ7u5mVgltAH14einqDMzdIGHfLmyD9gYoute8-G9n4gCe4). Qasur për herën e fundit më 26 mars 2021.

4. Mandati ligjor dhe funksioni i KGJK-së

KGJK funksionon si një institucion plotësisht i pavarur në ushtrimin e funksioneve të tij dhe gëzon pavarësi organizative, administrative e financiare për realizimin e detyrave të përcaktuara me Kushtetutë dhe me ligj. KGJK është organi i cili vendos për organizimin, menaxhimin, administrimin dhe mbikëqyrjen e funksionimit të gjykatave sipas ligjit.

Ndër përgjegjësitë kryesore të cilat i atribuohen KGJK-së, është rekrutimi dhe propozimi i kandidatëve për emërim dhe riemërim për pozita gjyqësore. Po ashtu, KGJK është institucioni i cili vendos edhe për përzgjedhjen, emërimin dhe shkarkimin e kryetarit të Gjykatës së Apelit dhe të kryetarëve të gjykatave themelore. Gjithashtu, KGJK i propozon Presidentit emërimin dhe shkarkimin e Kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës.¹⁰

Në kuadër të Këshillit funksionojnë pesë (5) komisione të përhershme të cilat janë; i) Komisioni për Çështje Normative; ii) Komisioni për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve; iii) Komisioni për

[ndalni-supermenet-dhe-ndalni-shperblimet-me-pagese-per-shtesa/?fbclid=IwAR2LoxcVUVj_vJ7u5mVgltAH14einqDMzdIGHfLmyD9gYoute8-G9n4gCe4](https://betimiperdrejtesi.com/ministrja-haxhiu-i-drejtohet-me-opinion-ligjor-akk-se-zbatoheni-drejte-ligjin-per-konflikt-te-interesit-ndalni-supermenet-dhe-ndalni-shperblimet-me-pagese-per-shtesa/?fbclid=IwAR2LoxcVUVj_vJ7u5mVgltAH14einqDMzdIGHfLmyD9gYoute8-G9n4gCe4)). Qasur për herën e fundit më 26 mars 2021.

¹⁰ Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Neni 108.

Administrimin e Gjykatave; iv) Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel dhe v) Komisioni për trajnime. Këto komisione udhëhiqen nga anëtarët e KGJK-së, kurse, KGJK mund të themelojë edhe komisione tjera sipas nevojës.¹¹

Në kuadër të KGJK-së, funksionon edhe Sekretariati i cili ka për detyrë të ndihmojë Këshillin për të zbatuar rregullat, rregulloret dhe politikat e Këshillit lidhur me menaxhimin, buxhetin dhe administrimin e gjykatave dhe po ashtu, i njëjti, harton edhe akte nënligjore, që janë të nevojshme për ushtrimin e funksioneve të Këshillit si dhe sipas udhëzimeve të Këshillit, përgatitë edhe propozim buxhetin për gjyqësorin dhe administron me buxhetin e miratuar të gjyqësorit. Sekretariati udhëhiqet nga Drejtori i Përgjithshëm i cili emërohet nga Këshilli dhe i cili ka pozitën e zyrtarit kryesor administrativ.¹²

5. Anëtarët e KGJK-së dhe pagat e tyre

a) Përbërja e KGJK-së

KGJK, përbëhet nga trembëdhjetë (13) anëtarë, të cilët emërohen për një mandat pesë (5) vjeçar, pa të drejtë rizgjedhje.

Shtatë (7) anëtarë të KGJK-së janë gjyqtarë të zgjedhur nga anëtarët e gjyqësorit, ku përfshihen, dy (2) gjyqtarë të Gjykatës Supreme, dy (2) gjyqtarë të Gjykatës së Apelit, tre (3) gjyqtarë të Gjykatave Themelore ndërsa, dy (2) anëtarë i zgjedhin deputetët e Kuvendit, të cilët i mbajnë vendet e fituara gjatë ndarjes së përgjithshme të vendeve dhe të paktën njëri prej këtyre të dyve, duhet të jetë gjyqtar.¹³

Dy (2) anëtarë të tjerë, i zgjedhin deputetët e Kuvendit, të cilët i mbajnë vendet e rezervuara ose të garantuara për përfaqësuesit e komunitetit Serb në Kosovë, dhe të paktën njëri prej këtyre të dyve, duhet të jetë gjyqtar kurse, dy (2) anëtarë i zgjedhin deputetët e Kuvendit, të cilët mbajnë vendet e rezervuara ose të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve të tjera, dhe të paktën njëri prej këtyre të dyve, duhet të jetë gjyqtar.

Këshilli, nga radhët e anëtarëve të vet gjyqtarë, zgjedh kryesuesin dhe

¹¹ Ligji nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës. Neni 16.


¹² Po aty. Neni 34.

¹³ Po aty. Neni 8.

zëvendës kryesuesin me mandat tre (3) vjeçar. Kryesuesi, zëvendës-kryesuesi, kryetari i Komisionit për Çështje Normative, kryetari për Çështjen e Vlerësimit të Performancës dhe kryetari i Komisionit për Administrimin e Gjykatave, shërbejnë në Këshill me kohë të plotë dhe pezullojnë detyrën e gjyqtarit.¹⁴

b) Pagat e anëtarëve të KGJK-së

Kryesuesi i KGJK-së, ka pagën ekuivalente me pagën e Kryetarit të Gjykatës Supreme, apo **2,950.00 euro** në muaj, kurse zëvendës-kryesuesi dhe anëtarët tjerë me orar të plotë pranojnë pagën ekuivalente me gjyqtarët e Gjykatës Supreme, apo **2,655.00 euro** në muaj.¹⁵



Grafika 1: Pagat në KGJK.

Sipas Ligjit për KGJK, kryesuesi si dhe anëtarët gjyqtarë me orar të plotë, pranojnë vetëm pagën e përcaktuar me ligj, përveç për rimbursime të shpenzimeve të arsyeshme dhe të

nevojshme që ndërlidhet me ushtrimin e detyrave të tyre.

Po ashtu, Kryesuesi, zëvendës-kryesuesi dhe anëtarët e Këshillit nuk kanë të drejtë të ushtrojnë ndonjë detyrë tjetër publike apo profesionale për të cilën shpërblehen me pagesë, përveç mësimdhënies në institucionet e arsimit të lartë¹⁶.

Anëtarët e tjerë të Këshillit që nuk janë me orar të plotë, vazhdojnë t'i marrin pagat e tyre si gjyqtarë, varësisht nga cila instancë gjyqësore vijnë.

c) Normimi i kundërligjshëm i shtesave në KGJK

Ligji për KGJK-në, i miratuar në vitin 2018, përcakton se anëtarët tjerë **jo-gjyqtarë** të Këshillit që nuk janë me orar të plotë, kanë të drejtë në kompensim për punën e tyre si anëtarë të Këshillit.¹⁷ Sipas skemës së kompensimit të miratuar nga KGJK, **anëtarët jo-gjyqtarë** kompensohen me pagë bazë ekuivalente me pagën e gjyqtarit të departamentit të përgjithshëm të gjykatës themelore, pa të drejtë kompensimi shtesë për punën e tyre në komisionet e përhershme dhe të përkohshme të KGJK.

Ligji për KGJK, në asnjë pjesë të tij nuk parasheh shtesa të tjera për anëtarët gjyqtarë të KGJK-së që janë me orar jo

¹⁴ Po aty. Neni 12 (2).

¹⁵ Po aty. Neni 18 (1).

¹⁶ Po aty. Neni 18 (5).

¹⁷ Neni 18 (2) i Ligjit. "Anëtarët jogjyqtarë të Këshillit që nuk janë me orar të plotë, kanë të drejtë

në kompensim për punën e tyre si anëtarë të Këshillit. Këshilli do të miratojë skemën e kompensimit".

të plotë në Këshill dhe të cilët vazhdojnë t'i pranojnë pagat e tyre të plota nga puna si gjyqtarë.

Pavarësisht kësaj, KGJK më 26 tetor 2020 kishte nxjerrë një vendim me të cilin përcakton se anëtarët gjyqtarë të KGJK-së, për punën e tyre në Këshill, në komisionet e përhershme dhe/apo të përkohshme të KGJK-së kompensohen në shumën fikse prej 262.75€ për muaj.¹⁸

Madje, KGJK kishte shkuar më larg se kaq, kur këto shtesa që nuk gjejnë mbështetje në Ligjin për KGJK dhe bien ndesh edhe me Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, i kishte normuar edhe me **Rregulloren Nr.03/2020 mbi Organizimin dhe Veprimtarinë e KGJK-së**.¹⁹

Neni 10.2. i kësaj rregulloreje përcakton se *“Anëtarët e Këshillit me orar jo të plotë dhe anëtarët jo gjyqtarë, për angazhimin e tyre në Këshill kompensohen, përkatësisht rimbursohen në bazë të skemës së kompensimit të miratuar nga Këshilli”*. Në rastin konkret, kjo pjesë e rregullores është tejkalim i përcaktimeve ligjore të dhëna në Ligjin për KGJK-në.

Këtë nen të rregullores, KGJK e bazon në interpretimin që sipas saj ka neni 18.2 i Ligjit për KGJK, që flet për kompensimet e anëtarëve jo-gjyqtarë.

Sipas KGJK-së, pjesa e parë e nenit 18.2 të Ligjit në fjalë aludon në përcaktimin e pagës për anëtarët jo-gjyqtarë të Këshillit, kurse, pjesa e dytë e nenit në fjalë, sipas KGJK-së, aludon në atë se Këshilli do të miratojë skemën e kompensimit për të gjithë anëtarët e KGJK-së. Për më tepër, sipas Këshillit një praktikë e tillë është edhe tek institucionet tjera dhe nuk bie ndesh me ligjin.²⁰

Është krejt e paqartë se si ka arritur KGJK, që një dispozitë e cila qartazi flet për kompensimin e anëtarëve jo-gjyqtarë, t'i jep kuptim ashtu që duke u bazuar në të njëjtën, të nxjerrë rregullore ku parasheh kompensime edhe për anëtarët tjerë të Këshillit me orar jo të plotë. Po ashtu, arsyetimi se një praktikë e tillë është tek institucionet tjera, nuk mund të merret e mirëqenë në këtë rast, pasi që dispozitat e Ligjit për KGJK janë të qarta në këtë aspekt dhe KGJK duhet t'i ndërtojë aktet nën-ligjore dhe praktikat bazuar në ligje e jo në praktika të institucioneve të tjera të cilat në fund të fundit, edhe ato mund të mos jenë konform ligjit.

Në rastin konkret, Ligji për KGJK-në është në përputhje me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, pasi që me Ligjin për KGJK janë paraparë paga vetëm për anëtarët që

¹⁸ Vendimi nr. 238/2020. KGJK. 26 tetor 2020.

¹⁹ Rregullore Nr. 03-2020 Mbi Organizimin dhe Veprimtarinë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës. KGJK. 6 gusht 2020.

²⁰ Përgjigje nga KGJK për IKD. 24 shkurt 2021.

janë me orar të plotë dhe e kanë pozitë parësore në KGJK si dhe kompensimet për anëtarët e KGJK-së që nuk janë gjyqtarë. Kurse, anëtarët tjerë gjyqtarë, funksionin dhe pagën e tyre parësore e kanë si gjyqtarë, andaj sa i përket anëtarëve të KGJK-së me orar jo të plotë dhe të cilët pranojnë pagën e gjyqtarit, KGJK është dashur të përcaktojë përmes skemës së kompensimit vetëm kompensimin për shpenzimet e udhëtimit dhe shpenzimet e tjera të lidhura me të, dhe jo edhe pagesë tjetër të veçantë krahas pagesë së tij si gjyqtar.

Me rregullore e skema të tilla të miratuara nga KGJK, kjo e fundit ka vendosur të normojë shtesa të kundërligjshme, duke minuar kështu aktet më të lartë siç janë në këtë rast Ligji për KGJK apo edhe Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Me këtë mënyrë të veprimit dhe shpërfilljes së ligjeve, KGJK por edhe institucione të tjera publike, po e zbehin edhe rëndësinë e draftimit dhe miratimit të ligjeve të avancuara të cilat garantojnë integritet të institucioneve dhe akterëve të përfshirë në këto institucione.

Për më tepër, një qasje e tillë e institucionit që menaxhon me gjyqësorin dërgon një mesazh jashtëzakonisht negativ tek publiku, si dhe hap rrugën e ndërtimit të praktikave të kundërligjshme edhe tek gjitha institucionet e tjera.

6. Shtesat dhe funksionet e anëtarëve të KGJK-së

IKD ka hulumtuar pozitat dhe shtesat e anëtarëve të KGJK-së duke u bazuar në deklaratimet e pasurisë që vet anëtarët që kishin bërë në vitin 2020. Përveç anëtarëve aktual që ka KGJK, IKD ka hulumtuar edhe për anëtarët që kishin qenë pjesë e Këshillit gjatë viteve 2019 dhe 2020.

Gjetjet e IKD-së tregojnë se, tre (3) anëtarë të KGJK-së, Driton Muharremi, Albert Zogaj dhe Nenad Lazic kishin ushtruar njëkohësisht nga tri (3) funksione. 10 anëtarë tjerë, kishin ushtruar nga dy (2) pozita, konkretisht, pozitën e anëtarëve në KGJK dhe atë të gjyqtarit. Këta anëtarë që kishin deklaruar se kanë ushtruar nga dy (2) pozita janë: Qerim Ademaj, Manushe Karaçi, Cerim Fazliji, Avni Mehmeti, Muhamet Rexha, Vilard Bytyqi, Nehat Idrizi, Armend Berisha, Gjimshti Galushi dhe Anita Krasniqi-Prenaj. Kurse, anëtarët Radojka Trifunovic, Makifete Saliuka dhe Teuta Ibrahimimi kishin deklaruar se kanë ushtruar vetëm nga një (1) pozitë. Kurse, sa i përket kryesuesit Çoçaj, i njëjti ka deklaruar se ka pasur vetëm pozitën e kryesuesit, mirëpo, bazuar në të hyrat që i njëjti ka deklaruar, është kontestuese nëse i njëjti ka qenë edhe trajnues në Akademinë e Drejtësisë, pasi nga ky institucion i ka deklaruar si të ardhura nga shërbimet e trajnimit, mbi 1,000 euro.

Sa i përket shtesave, 76% apo 13 anëtarë e ish-anëtarë të KGJK nga gjithsej 17 sa janë analizuar, kanë deklaruar se kanë pranuar shtesa e kompensime të ndryshme, kurse katër (4) anëtarë, nuk kanë deklaruar se kanë pranuar ndonjë shtesë tjetër krahas pagave të tyre.



Grafika 2: Përqindja e anëtarëve të KGJK-së që kanë deklaruar shtesa krahas pagave të tyre.

Ligji për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë, ka përcaktuar dispozita të qarta lidhur me mënyrën se si zyrtarët publikë duhet të deklarojnë pasurinë e tyre.²¹

Në nenin 3.2 të ligjit të lartcekur, është përcaktuar decidivisht mënyra se si zyrtarët duhet të deklarojnë pasurinë, ku thuhet se: “Në deklaratën për pasurinë

e të ardhurave dhe detyrimeve financiare, zyrtari i lartë publik cek **shumën, llojin dhe burimin e secilës të ardhur, shumën dhe llojin e detyrimeve financiare duke përfshirë edhe emrin e kreditorit si person fizik apo juridik, ndërsa publikimi i emrit të kreditorit bëhet vetëm për personat juridik”.**

Por, përkundër se sipas kësaj dispozite është qartësuar fakti se zyrtarët publik duhet të deklarojnë secilën të hyrë të tyre, sipas **shumës, llojit dhe burimit** të tyre, në praktikë, shumë zyrtarë, duke përfshirë këtu edhe anëtarë të KGJK-së dhe KPK-së, të hyrat e tyre i deklarojnë në kundërshtim me kërkesat ligjore. Në vijim është paraqitur analiza për secilin prej anëtarëve të KGJK-së.

i. Skënder Çoçaj

Në deklarimin e pasurisë që kishte bërë në vitin 2020, kryesuesi i KGJK-së, Skender Çoçaj kishte deklaruar pagë vjetore në lartësi prej 31,492.00 euro. Të ardhura të tjera, z. Çoçaj i kishte deklaruar 3,032.00 euro si mëditje nga KGJK për udhëtimet zyrtare, 2,765.00 euro si shpenzime të udhëtimit nga Këshilli i Evropës dhe 1,145.00 euro nga shërbimet e trajnimit në Akademinë e Drejtësisë. Në total, kryesuesi kishte deklaruar të hyra vjetore në shumë prej 38,434.00 euro.

Z. Çoçaj, sipas deklarimit të tij pasurisë, nuk ka paraqitur ndonjë pozitë tjetër

²¹ Ligji nr. 04/L-050 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe

kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë.

përveç asaj të kryesuesit të KGJK-së, përkundër asaj se nga deklarimi i të hyrave të tij, del se i njëjti kishte realizuar të ardhura nga shërbimet e trajnimit nga Akademi e Drejtësisë.

Me këtë rast, siç shihet nga deklarim i tij i pasurisë, z. Çoçaj ka pranuar 1,145.00 euro nga shërbimet e trajnimit në Akademi të Drejtësisë. Një gjë e tillë del së është në kundërshtim me nenin 18 (5) të Ligjit për KGJK-në, i cili specifikisht ia ndalon kryesuesit të ushtrisë ndonjë detyrë tjetër publike apo profesionale për të cilën shpërblehet me pagesë.

Kryesuesi, zëvendëskryesuesi dhe anëtarët e Këshillit nuk kanë të drejtë të ushtrinë ndonjë detyrë tjetër publike apo profesionale për të cilën shpërblehen me pagesë, përveç mësimdhënies në institucionet e arsimit të lartë – **neni 18. 5 i Ligjit për KGJK.**

Nga kjo del se, detyrat që kishte ushtruar në kuadër të Akademisë së Drejtësisë, z. Çoçaj i kishte bërë në mënyrë të kundërligjshme, siç del të jenë të kundërligjshme edhe shtesat që kishte marrë nga ky institucion.

ii. Qerim Ademaj

Zëvendës-kryesuesi i KGJK-së, Qerim Ademaj, në deklarimin e tij të pasurisë, ka paraqitur të hyra nga paga prej 26,492.21 euro. Përveç pagës, i njëjti ka deklaruar si të hyra edhe 641,25 euro nga mëditjet për trajnime në Akademi

të Drejtësisë si dhe 66 euro mëditje për ushqim nga KGJK. Në total, z. Ademaj kishte deklaruar të hyra prej 27,199.00 euro. Sa i përket pozitave, z. Ademaj në kohën e deklarimit të pasurisë kishte mbajtur pozitat e gjyqtarit dhe atë të anëtarit me orar jo të plotë në KGJK. Pas zgjedhjes së tij si zëvendës-kryesues, i njëjti është tashmë anëtar me orar të plotë në KGJK dhe ka pezulluar punën e tij si gjyqtar.

iii. Driton Muharremi

Anëtari tjetër i KGJK-së, gjyqtari Driton Muharremi, në deklarimin e tij të pasurisë në vitin 2020, kishte deklaruar se përveç pozitës së gjyqtarit, mbante edhe pozitën e zëvendës-kryesuesit në Këshillin Drejtues të Akademisë së Drejtësisë si dhe atë të ligjëruesit në Kolegjin “AAB”.

Si të ardhura vjetore nga paga dhe nga Akademia e Drejtësisë, z. Muharremi kishte deklaruar shumën prej 27,923.00 euro. Me këtë rast, z. Muharremi nuk i kishte ndarë të hyrat që kishte pranuar nga dy burime të ndryshme, siç janë KGJK dhe Akademia e Drejtësisë, por, të dy këto lloje të të hyrave nga dy burime të ndryshme i kishte paraqitur së bashku, duke e bërë të pamundur për publikun të kuptojë se sa nga këto të hyra z. Muharremi i kishte pranuar nga paga e tij si gjyqtar e sa të tjera nga pozita që mbante në Këshillin Drejtues në Akademinë e Drejtësisë.

Ndërsa, 6,402.00 euro të hyra, gjyqtari Muharremi i kishte deklaruar nga

Kolegji "AAB". Gjithashtu, i njëjti kishte deklaruar edhe 300 euro të hyra nga IKT dhe 69 euro mëditje tjera nga gjykata-sekretariati. Si total i të hyrave vjetore që kishte pasur. z. Muharremi kishte deklaruar 34,694.00 euro.

Lidhur me të hyrat që kishte realizuar nga Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë, z. Muharremi është thirrur në ligjin për Akademinë e Drejtësisë, konkretisht në nenin 13 të ligjit, në të cilin thuhet se anëtarët e Këshillit Drejtues kanë të drejtë në kompensim për pjesëmarrje në mbledhje.²²

Në rastin e z. Muharremi, del se i njëjti kishte qenë anëtar i një organi drejtues të një institucioni, siç është rasti Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë ku gjyqtari Muharremi kishte qenë zëvendës-kryesues. Duke qenë se i njëjti nuk kishte pasur pozita tjera drejtuese atëherë mbajtja e këtij funksioni nuk bie ndesh me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit. Përkundër kësaj, sipas ligjit, i njëjti nuk ka të drejtë të pranojë shpërblime me pagesë por vetëm kompensime për udhëtim dhe kompensime që lidhen me to. Por, për shkak të mënyrës së deklarimit të të ardhurave nga gjyqtari Muharremi, nuk është e mundur të identifikohen se sa kishin qenë të hyrat që i njëjti kishte realizuar nga pozita që kishte pasur në Këshillin Drejtues të Akademisë, dhe rrjedhimisht,

analizimi nëse të njëjtat të hyra ishin në përputhje me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit. Lidhur me mos deklarimin e të hyrave veç e veç, z. Muharremi ka deklaruar se e ka pasur të vështirë të identifikojë saktë shumën që e ka marrë nga Akademia, pasi siç ka thënë, të njëjtat të hyra i kanë dal bashkë me pagën nga KGJK.²³

iv. Anita Krasniqi - Prenaj

Anëtarja tjetër e KGJK-së, Anita Krasniqi-Prenaj, në deklarimin e saj të pasurisë, kishte theksuar se ka realizuar të hyra vjetore nga paga dhe mëditjet për udhëtime jashtë vendit, shumë prej 29,347.44 euro. Burimin e këtyre të hyrave, Krasniqi-Prenaj e kishte deklaruar KGJK-në dhe Akademinë e Drejtësisë, pa i ndarë kështu veç e veç, as llojin e të hyrave e as burimin e tyre. Si rrjedhojë, për publikun është e pamundur të dijë se sa nga të hyrat që kishte realizuar gjyqtarja, kishin qenë nga mëditjeje e ndryshme, e sa nga to kishin qenë nga paga e saj bazë. Po ashtu, përkundër se ka deklaruar të hyra nga Akademia e Drejtësisë, gjyqtarja nuk ka cekur llojin e tyre dhe nëse këto të hyra kishin qenë shpërblim me pagesë për ndonjë detyrë që znj. Krasniqi-Prenaj ka mundur të ushtrojë në Akademi. Sa i përket ushtrimit të detyrave të tjera ku parashihet shpërblimi me pagesë, vlejné argumentet e njëjta që janë dhënë tek rasti i z. Çoçaj. Sa i përket pozitave,

²² Përgjigje përmes adresës elektronike e z.Muharremi për IKD. 11 mars 2021.

²³ Po aty.

znj. Krasniqi-Prenaj, si anëtare e KGJK-së është e zgjedhur si kryetare e Komisionit për Çështje Normative në kuadër të Këshillit. Këtë pozitë, e njëjta e mban me orar të plotë, kurse pozitën e gjyqtares e ka të pezulluar.

v. Nenad Lazić

Gjyqtari Nenad Lazić, në deklarin e tij të pasurisë të bërë në vitin 2020, ka theksuar se përveç pozitës së gjyqtarit dhe të anëtarit në KGJK, ka qenë pjesë edhe e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP). Si pagë vjetore, z. Lazić ka deklaruar shumën prej 29,762.34 euro, kurse si të ardhura nga PZAP, gjyqtari Lazić ka deklaruar të hyre prej 5,422.51 euro. Si total, të hyra vjetore që kishte deklaruar gjyqtari kishin qenë 35,184.00 euro.

Lidhur me ushtrimin e detyrave tjera publike për të cilat është paraparë shpërblimi me pagesë, siç është rasti në PZAP i z. Lazić, vlej të njëjtat argumente sikurse të z. Çoçaj.

Në këtë rast, është e rëndësishme të ceket se sipas Ligjit për Zgjedhje, konkretisht nenit 116.2, anëtarët e PZAP-it, në një periudhë prej 60 ditë para ditës së zgjedhjeve deri në certifikimin e rezultateve të zgjedhjeve, i japin përparësi të plotë obligimeve të tyre si anëtar të PZAP-it. Rrjedhimisht, në këtë kohë, del se për z. Lazić dhe gjyqtarët tjerë të PZAP-it puna e tyre si gjyqtarë në gjykatat ku ata shërbejnë

bëhet detyrësore. Por, përkundër kësaj, z. Lazić dhe gjyqtarët tjerë të PZAP-it vazhdojnë t'i marrin pagat e tyre të plota si gjyqtarë, ndërsa, përveç këtyre, ata shpërblehen edhe me të ardhura nga PZAP që tejkalojnë edhe pagat mesatare vjetore të qytetarëve të Kosovës. Po ashtu, gjyqtarët e PZAP-it, përkundër asaj se aktivizohen thuhet ekskluzivisht vetëm në kohën e zgjedhjeve, të njëjtat vazhdojnë të pranojnë pagë gjatë gjithë vitit.

vi. Manushe Karaçi

Anëtarja tjetër nga radhët e Gjykatës Supreme, Manushe Karaçi, në deklarin e saj të pasurisë ka deklaruar shumën prej 30,511.55 euro, si të ardhura nga paga dhe mëditjet tjera nga KGJK. Këto dy lloje të të ardhurave, gjyqtarja Karaçi nuk i ka deklaruar si të ndara veç e veç, porse, të njëjtat i ka deklaruar së bashku brenda një rubrike. Sa i përket bazës ligjore mbi të cilën i ka pranuar shtesat tjera, znj. Karaçi ka thënë se të njëjtat i ka realizuar në bazë të vendimeve të KGJK-së bazuar në punën e saj në komisionet brenda Këshillit.²⁴ Znj. Karaçi ka përfunduar mandatin e saj në KGJK në fillim të muajit mars 2021.

vii. Çerim Fazlji

Gjyqtari nga radhët e Gjykatës Supreme, Çerim Fazlji, që është njëkohësisht edhe anëtar i KGJK-së, si pagë vjetore në deklarin e tij të

²⁴ Përgjigje përmes adresës elektronike nga znj. Karaçi për IKD. 24 shkurt 2021.

pasurisë ka deklaruar 30,761.40 euro, kurse, 244 euro të tjera i ka deklaruar si mëditje nga KGJK. Si total, z. Fazliji kishte deklaruar të hyra vjetore prej 31,005.00 euro.

viii. Avni Mehmeti

Gjyqtari Avni Mehmeti, i cili ishte zgjedhur anëtar i KGJK-së në shkurt të vitit 2020, kishte deklaruar si pagë mujore shumën prej 1,962.05, përjashtimisht një muaji, për të cilën kishte theksuar se ka pranuar pagë mujore prej 1,905.89 euro. Sipas këtij deklarimi, del se z. Mehmeti kishte realizuar si pagë vjetore shumën prej 23,487.00 euro. Gjithashtu, z. Mehmeti ka deklaruar edhe 145 euro mëditje për udhëtim zyrtar nga KGJK, si dhe 136 euro nga trajnimet në Akademinë e Drejtësisë. Si total i të hyrave vjetore, gjyqtari Mehmeti ka realizuar 23,768.00 euro. Sa i përket pozitave, z. Mehmeti ka deklaruar se përveç pozitës së gjyqtarit mban edhe pozitën e anëtarit të KGJK-së, kurse pozita tjera ka deklaruar se nuk mban.

ix. Muhamet Rexha

Gjyqtari Muhamet Rexha, në deklarimin e tij të pasurisë, ka deklaruar pagë mujore 2,666.79 euro, që si pagë vjetore përkthehet në 32,001.48 euro. Po ashtu, gjyqtari Rexha kishte deklaruar edhe 376 euro mëditje nga udhëtimet jashtë vendit ashtu që si total, del se z. Rexha kishte realizuar 32,377.48 euro të ardhura vjetore.

x. Radojka Trifunovic

Anëtarja e KGJK-së, Radojka Trifunovic, në deklarimin e saj të pasurisë në vitin 2020, ka potencuar se nuk ushtron ndonjë pozitë tjetër përveç anëtares në KGJK, kurse si pagë ka deklaruar shumën prej 1,656.00 euro, që nëse e përkthejmë në pagë vjetor del se ka pranuar 19,872.00 euro. Njëherit, znj. Trifunovic është e vetmja prej anëtarëve të KGJK-së që ka deklaruar se mban vetëm një pozitë dhe ndër katër (4) të vetmet që nuk ka deklaruar ndonjë shtesë.

xi. Vilard Bytyqi

I zgjedhur si anëtar i KGJK-së në gusht të vitit 2020, z. Vilard Bytyqi, ka theksuar në deklarimin e tij të pasurisë, se deri në plotësimin e formularit për deklarim të pasurisë, nuk kishte pranuar asnjë kompensim nga KGJK. Ndërsa si pagë nga Akademia e Kosovës për Siguri Publik (AKSP) – Fakulteti i Sigurisë Publike, z. Bytyqi kishte deklaruar pagën prej 1,133.65 euro, që nëse e përkthejmë në pagë vjetore del se ka realizuar 13,603.80 euro. Si kompensim dhe mëditjet tjera nga AKSP, z. Bytyqi kishte deklaruar të ardhura prej 300 euro ashtu që si total i të ardhurave vjetore, z. Bytyqi kishte deklaruar 13,903.80 euro.

Sa i përket pozitave, i njëjti kishte deklaruar se mban pozitën e profesorit në AKSP dhe atë të anëtarit në KGJK.

xii. Nehat Idrizi

Gjyqtari nga radhët e Gjykatës së Apelit, Nehat Idrizi, kishte qenë kryesues i KGJK-së deri në mars 2019, kurse pas mbarimit të mandatit si kryesues, i njëjti kishte vazhduar të jetë anëtar i Këshillit deri në dhjetor 2019, kohë në të cilën kishte dhënë dorëheqje. Si të ardhura vjetore nga paga e tij, z. Idrizi kishte deklaruar 35,738.92 euro, kurse, 224.84 euro i kishte deklaruar mëditje nga KGJK. Nga shërbimet e trajnimit dhe arsimit në Akademinë e Drejtësisë, gjyqtari Idrizi kishte deklaruar 384 euro. Totali i të hyrave që kishte deklaruar z. Idrizi është 36,348.00 euro. Sa i përket të hyrave që kishte realizuar nga Akademia e Drejtësisë, z. Idrizi thotë se të njëjtat janë realizuar në bazë të kontratës për shërbime të veçanta të trajnimit siç përcaktohet me aktet ligjore të Akademisë së Drejtësisë, siç është Rregullorja për Programin e Trajnimit Fillestar për Gjyqtar, kurse për mëditjet e realizuara nga KGJK, gjyqtari thekson se të njëjtat i ka pranuar nga udhëtimet zyrtare.²⁵

Sa i përket shtesave që kishte marrë nga Akademia e Drejtësisë, vlejné të njëjtat argumente të dhëna tek z. Çoçaj dhe të gjyqtarët e tjerë.

xiii. Armend Berisha

Gjyqtari Armend Berisha kishte qenë pjesë e KGJK-së deri në nëntor 2019,

kur kishte dhënë dorëheqje nga pozita e anëtarit, për t'iu futur garës për kryetar të Gjykatës Themelore në Pejë. Garën për kryetar, z. Berisha e kishte fituar dhe i njëjti në korrik 2020 ishte zgjedhur kryetar i GjTh Pejë. Por, ky kandidim dhe më pas zgjedhja e tij nga KGJK, del se ka qenë në kundërshtim të plotë me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit. Neni 18 i këtij ligji ka përcaktuar kufizimet e zyrtarit të lartë pas përfundimit të ushtrimit të detyrës publike ku thuhet se: *“Zyrtari i lartë nuk ka të drejtë: 1.1 të punësohet ose të emërohet për një periudhë deri në dy (2) vjet pas përfundimit të funksionit publik, në pozitë udhëheqëse ose menaxhuese, apo të përfshihet në kontrollin ose auditimin e institucioneve publike dhe private dhe institucioneve vartëse të tyre të cilat kanë marrëdhënie biznesi me institucionin ku ka ushtruar funksioni publik, nëse detyrat e tij gjatë periudhës dy-vjeçare para përfundimit të ushtrimit të funksionit publik kanë qenë të drejtpërdrejtë të lidhura me mbikëqyrjen, kontrollin apo sanksionimin e aktivitetit të tyre...”*. Në këtë rast, gjyqtari Berisha si zyrtar i lartë, ishte emëruar në një pozitë udhëheqëse të një institucioni vartës të KGJK-së, siç është GjTh Pejë vetëm rreth tetë (8) muaj pasi kishte përfunduar funksionin e tij në KGJK. Pra, i njëjti nuk e kishte përfillur fare ndalesën dy (2) vjeçare për tu emëruar në një pozitë të tillë, siç përcaktohet me

²⁵ Përgjigje përmes adresës elektronike e z. Idrizi për IKD. 12 mars 2021.

Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit. Në këtë mënyrë, Berisha në kundërshtim me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik ishte zgjedhur kryetar i Gjykatës Themelore në Pejë.

Në deklarin e tij të pasurisë, z. Berisha ka theksuar se përveç pozitës së anëtarit në KGJK dhe gjyqtarit nuk ka ndonjë pozitë tjetër. Duke qenë se z. Berisha ka qenë kryetar i Komisionit për Çështje Normative, i njëjti ka qenë anëtar i Këshillit me orar të plotë ndërsa pozitën e gjyqtarit e ka pasur të pezulluar.

Si të ardhura vjetore nga paga dhe kompensime të tjera nga puna si anëtar në KGJK, z. Berisha kishte deklaruar 27,605.37 euro. Këto të ardhura, gjyqtari Berisha i kishte deklaruar së bashku pa i ndarë ato sipas shumës dhe llojit të tyre. Po ashtu, i njëjti kishte deklaruar edhe 485.20 euro nga mëditjet dhe shpenzime të realizuar në udhëtime zyrtare, por as këto të hyra nuk i kishte ndarë sipas burimit të tyre.

xiv. Makifete Saliuka

Gjyqtarja Makifete Saliuka, në deklarin e saj të pasurisë të bërë në mars 2020, si të vetmin funksion që ushtron e kishte listuar atë të gjyqtares, edhe pse atëkohë, e njëjta kishte qenë edhe zëvendës-kryesuese e KGJK-së. Ndërsa, sa i përket të hyrave, e njëjta i kishte deklaruar si të ardhura nga paga shumë prej 30,002.00 euro, kurse nuk

kishte deklaruar se ka pranuar ndonjë shtesë tjetër.

xv. Gjimeshit Galushi

Gjyqtari Gjimeshit Galushi, në deklarin e tij të pasurisë në vitin 2020, kishte listuar si pozita të cilat i kishte mbajtur, atë të gjyqtarit dhe të anëtarit në KGJK. Si të hyra nga paga, i njëjti i kishte deklaruar 27,751.78 euro, kurse nuk kishte deklaruar se ka pranuar ndonjë shtesë tjetër.

xvi. Albert Zogaj

Gjyqtari Albert Zogaj, i cili ishte zgjedhur anëtar i KGJK-së më 10 mars 2021, në deklarin e tij të pasurisë të bërë në vitin 2020, ka treguar se përveç pozitës së gjyqtarit, është edhe ligjërues në Kolegjin AAB. Po ashtu, gjatë vitit 2019, z. Zogaj ka qenë edhe pjesë e Komisionit për Dhënien e Provimit të Jurisprudencës. Si pagë vjetore, z. Zogaj ka deklaruar shumë prej 26,303.41 euro, që paraqet pagën e tij si gjyqtar i Apelit në kohën e deklarin të pasurisë. Nga kolegji AAB, z. Zogaj ka deklaruar 5,472.00 euro të ardhura, kurse, 6,935.29 euro të ardhura tjera i kishte deklaruar nga KGJK, Komisioni për Dhënien e Provimit të Jurisprudencës, Akademia e Drejtësisë dhe angazhime të tjera. Këto të fundit, z. Zogaj nuk i kishte ndarë sipas shumës, llojit apo burimit të tyre, siç kërkohet me Ligjin për Deklarin e Pasurisë, por të gjitha bashkë i kishte deklaruar në një rubrikë. Si total, z. Zogaj kishte deklaruar të ardhura

vjetore prej 38,710.00 euro. Lidhur me këto të hyra shtesë që kishte realizuar krahas pagës bazë, gjyqtari Zogaj ka theksuar se të njëjtat i ka deklaruar konform ligjit.²⁶ Më 26 janar 2021, KGJK kishte nxjerrë një vendim me të cilin, z. Zogaj i kishte lejuar të angazhohet si konsulent i pavarur në projektin e organizatës jo-qeveritare "Inject". Në këtë pozitë, sipas vendimit të KGJK-së, gjyqtari Zogaj do të qëndrojë për një periudhë pesë mujore ndërsa do të paguhet nga 506,40 cent, apo në total 2,532.00 euro. Me këtë rast, pasi që z. Zogaj është zgjedhur si anëtar i KGJK-së, angazhimi i tij me pagesë si konsulent i pavarur në një OJQ del nuk është në përputhje me Ligjin për KGJK, pasi ky ligj, në nenin 18.5 të tij përcakton se *"Kryesuesi, zëvendëskryesuesi dhe anëtarët e Këshillit nuk kanë të drejtë të ushtrojnë ndonjë detyrë tjetër publike apo profesionale për të cilën shpërblehen me pagesë, përveç mësimit në institucionet e arsimit të lartë."* Rrjedhimisht, z. Zogaj, duke qenë anëtar i KGJK-së, i bie që nuk ka të drejtë të ushtrojë një detyrë tjetër profesionale, sikurse konsulent i pavarur, për të cilën detyrë ai pranon shpërblim me pagesë.

xvii. Teuta Ibrahimimi

Gjyqtarja Teuta Ibrahimimi ishte zgjedhur anëtare e KGJK-së më 10 mars 2021, nga radhët e Gjykatës Supreme. Në

²⁶ Përgjigje përmes adresës elektronike e z. Zogaj për IKD. 22 shkurt 2021.

deklarimin e saj të pasurisë, znj. Ibrahimimi ka theksuar se nuk ka ushtruar pozitë tjera përveç asaj të gjyqtarës, kurse të ardhura vjetore nga paga ka deklaruar shumën prej 30,761.40 euro. Gjyqtarja Ibrahimimi nuk ka deklaruar se ka realizuar ndonjë shtesë tjetër nga detyra tjera që ka mundur t'i ushtrojë.

xviii. Shkëlzen Maliqi

Formulari i deklarimit të pasurisë i vitit 2020 i drejtorit të sekretariatit në KGJK, Shkëlzen Maliqi, ndonëse figuron në faqen e Agjencisë Kundër Korrupsion, i njëjti nuk hapet. Lidhur me këtë, nga AKK janë arsyetuar se ka ndodhur një lëshim teknik, mirëpo pavarësisht kësaj të njëjtit nuk kanë ndërmarrë hapa për të rregulluar këtë lëshim teknik siç kanë thënë, edhe pse në një përgjigje për IKD-në, kanë theksuar se tanimë kanë publikuar formularin në fjalë. Po ashtu, as formulari i deklarimit të pasurisë për vitin 2019 i z. Maliqit nuk hapet në faqen e AKK-së.²⁷

²⁷ Përgjigje nga AKK për IKD. 24 shkurt 2021.

7. Mandati ligjor dhe funksioni i KPK-së

Këshilli Prokurorial i Kosovës është institucion i pavarur në kryerjen e funksioneve të tij, i cili Këshill, ndër të tjera duhet të sigurojë që Prokurori i Shtetit të jetë i pavarur, profesional, i paanshëm.²⁸

KPK ka mandat ligjor që vendos për organizimin, menaxhimin, administrimin dhe mbikëqyrjen e funksionimit të prokurorive sipas ligjit si dhe është institucioni i cili i propozon Presidentit emërimin, riemërimin dhe shkarkimin e prokurorëve dhe i propozon Presidentit emërimin dhe shkarkimin e Kryeprokurorit të Shtetit. Po ashtu, KPK është institucioni i cili vendos për emërimin e kryeprokurorëve të Prokurorive Themelore, Prokurorisë Speciale dhe Prokurorisë së Apelit dhe vendos për avancimin, transferimin dhe disiplinimin e prokurorëve.²⁹

Këshilli ka komisionet e veta të përhershme siç janë; Komisioni për Çështje Normative; Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel; Komisioni për Administrimin e Prokurorive dhe Komisioni për vlerësim të performancës së prokurorëve. Këshilli mund të themelojë edhe komisione të tjera të

përkohshme ose të përhershme, sipas nevojës.³⁰

Në kuadër të KPK-së, funksionon edhe Sekretariati i cili ndihmon Këshillin për të zbatuar rregullat, rregulloret dhe politikat e Këshillit lidhur me menaxhimin, buxhetin dhe administrimin e prokurorit të shtetit. Sipas udhëzimeve të Këshillit apo me vet iniciativë, ky Sekretariat propozon politika dhe akte nënligjore, që janë të nevojshme për ushtrimin e funksioneve të Këshillit dhe zbatimin e këtij ligji. Gjithashtu, sipas udhëzimeve të Këshillit, Sekretariati përgatitë propozim buxhet të konsoliduar për Këshillin dhe Prokurorin e Shtetit dhe administron buxhetin e miratuar.

Sekretariati udhëhiqet nga Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit, i cili përzgjidhet, emërohet dhe shkarkohet nga Këshilli.³¹

²⁸ Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Neni 110.

²⁹ Ligji nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës. Neni 7.

³⁰ Po aty. Neni 16.

³¹ Po aty. Neni 31.

8. Anëtarët e KPK-së dhe pagat e tyre

a) Përbërja e KPK-së

Këshilli, përbëhet nga trembëdhjetë (13) anëtarë. Dhjetë (10) anëtarë të KPK-së, vijnë nga radhët e prokurorëve, ku përfshihen, Kryeprokurori i Shtetit; shtatë (7) anëtarë, prokurorë nga prokuroritë themelore, të përfaqësuar me nga një (1) anëtar, të zgjedhur nga prokurorët e asaj prokurorie; një (1) anëtar, prokuror nga Prokuroria e Apelit, i zgjedhur nga prokurorët e asaj prokurorie; një (1) anëtar, prokuror nga Prokuroria Speciale, i zgjedhur nga prokurorët e asaj prokurorie; një (1) anëtar avokat nga Oda e Avokatëve të Kosovës; një (1) anëtar, profesor universitar i drejtësisë dhe një (1) anëtar, përfaqësues nga shoqëria civile.³²

Përveç kryeprokurorit të shtetit, anëtarët e tjerë të Këshillit nuk mund të ushtrojnë njëkohësisht detyrën e kryeprokurorit të cilësdo prokurori. Tre (3) anëtarët jo-prokurorë të Këshillit zgjedhën nga Kuvendi i Kosovës.

Anëtarët e Këshillit qëndrojnë në detyrë për një mandat pesë (5) vjeçar, pa të drejtë rizgjedhjeje.


Këshilli nga radhët e anëtarëve të vet prokurorë, zgjedh kryesuesin dhe

zëvendës-kryesuesin, me mandat tre (3) vjeçar.

Kryesuesi, zëvendës-kryesuesi, kryetari i Komisionit për Çështje Normative, kryetari për Çështjen e Vlerësimin të Performancës dhe kryetari për Administrimin e Prokurorive, shërbejnë në Këshill me kohë të plotë dhe pezullojnë detyrën e prokurorit.

b) Pagat e anëtarëve në KPK

Kryesuesi i KPK-së, ka pagën ekuivalente me atë të Kryetarit të Gjykatës Supreme, apo **2,950.00 euro** në muaj, kurse zëvendës-kryesuesi dhe anëtarët e Këshillit me orar të plotë pranojnë pagën ekuivalente të gjyqtarit të Gjykatës Supreme, apo **2,655.00 euro** në muaj.³³



Grafika 3: Pagat në KPK.

Anëtarët e tjerë të Këshillit me orar jo të plotë, vazhdojnë t'i marrin pagat e tyre si prokurorë, varësisht nga cili nivel i prokurorisë vijnë.

³² Po aty. Neni 9.

³³ Po aty. Neni 18.

Gjatë mandatit të tyre, kryesuesi, si dhe anëtarët prokurorë, me orar të plotë pranojnë vetëm pagën e përcaktuar me ligj, përveç për rimbursime të shpenzimeve të arsyeshme dhe të nevojshme që ndërlidhet me ushtrimin e detyrave të tyre. Kryesuesi, zëvendës-kryesuesi dhe anëtarët prokurorë të Këshillit nuk kanë të drejtë të ushtrojnë ndonjë detyrë tjetër publike apo profesionale për të cilën shpërblehen me pagesë, përveç mësimdhënies në institucionet e arsimit të lartë, Akademisë së Drejtësisë apo rasteve të parapara me ligj.

Për dallim nga Ligji për KGJK, i cili përcaktonte kompensime vetëm për anëtarët jo-gjyqtarë me orar jo të plotë, sipas Ligjit për KPK, është përcaktuar se të gjithë anëtarët e tjerë të Këshillit me orar jo të plotë kanë të drejtë në kompensim për punën e tyre si anëtarë të Këshillit. Kësisoj, sipas këtij ligji, edhe atë prokurorë që janë anëtarë me orar jo të plotë, do të marrin kompensime në formë të shpërblimit me pagesë për punën e tyre në Këshill.

Kjo edhe pse ky angazhim i këtyre prokurorëve bëhet gjatë orarit të tyre të rregullt të punës, për të cilën kohë, ata pranojnë pagën e plotë si prokurorë. Duke qenë se Ligji për KPK-në ka hyrë në fuqi më vonë se sa Ligji për Parandalimin për Konfliktin të Interesit, i njëjti ka dështuar të përcjell frymën mbi të cilën është miratuar Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit. Ky i fundit, e ka ndaluar praktikën e

shpërblimeve me pagesë për ushtrimin e pozitave të tjera krahas pozitës bazë për zyrtarët publik dhe i ka lejuar vetëm kompensimet që lidhen me shpenzimet e udhëtimit dhe të ngjashme. Porse, siç shihet nga praktika, ligje e institucionet të tjera, kanë vazhduar që herë me akte ligjore e herë edhe pa to, të vazhdojnë praktikën e shtesave të ndryshme e të kundërligjshme.


9. Shtesat dhe funksionet e anëtarëve të KPK-së

IKD ka hulumtuar funksionet dhe shtesat e anëtarëve aktual të KPK-së si dhe të ish-anëtarëve të Këshillit që mandatin e tyre e kishin përfunduar në fund të vitit 2020.

Nga 18 anëtarët dhe ish-anëtarët e KPK-së, sipas deklarimeve të pasurisë që të njëjtit kishin bërë në vitin 2020, del se një (1) anëtar i KPK-së, konkretisht, kryeprokurori i shtetit, Aleksandër Lumezi kishte mbajtur gjashtë (6) pozita njëkohësisht, kurse, tre (3) anëtarë tjerë të KPK-së, kishin pasur nga tri (3) pozita. Anëtarët që kishin ushtruar nga tri (3) pozita kishin qenë, Merita Bina-Rugova, Dëshirë Jusaj dhe Ardian Hajdaraj. Shtatë (7) anëtarë të tjerë kishin deklaruar se kishin mbajtur nga dy (2) pozita. Anëtarët që sipas deklarimeve të tyre të pasurisë të bëra në vitin 2020, kanë ushtruar nga dy pozita, janë Jetish Maloku, Bedrije Sylaj-Alshiqi, Haxhi Sinanaj, Radica Milic, Veton Shabani, Agron Beka dhe

Ikramije Bojaxhiu. Ish-kryesuesi Bahri Hyseni kishte deklaruar se ka ushtruar vetëm funksionin e tij si kryesues, por nga deklarimi i tij të ardhurave del se i njëjti ishte shpërblyer edhe për shërbime të trajnimit në Akademinë e Drejtësisë, çka jep të kuptojë se i njëjti ka qenë edhe trajnues në këtë institucion. Gjashtë (6) anëtarë tjerë kishin deklaruar se kanë ushtruar vetëm nga një pozitë, duke përfshirë këtu katër (4) anëtarë që ishin bërë pjesë e KPK-së në fund të vitit 2020 konkretisht, Agron Beka, Jehona Grantolli, Arjana Shajkovi dhe Jovo Radovic si dhe anëtarët Arben Ismajli e Zejnullah Gashi.

Sa i përket shtesave, 13 nga 18 anëtarët e ish-anëtarët e KPK-së, apo 72% të tyre kanë deklaruar se kanë marrë shtesa e kompensime të ndryshme në deklarimin e tyre të pasurisë që kishin bërë në vitin 2020. Të vetmit që nuk kishin deklaruar shtesa të tjera kishin qenë pesë (5) anëtarë që janë zgjedhur në Këshill në vitin e kaluar. Drejtori i sekretariatit në KPK, Lavdim Krasniqi, në deklarimin e tij të pasurisë kishte theksuar se mban tri (3) pozita dhe po ashtu kishte deklaruar se ka realizuar edhe paga e shtesa të ndryshme.



Grafika 4: Përqindja e anëtarëve të KPK-së që kanë deklaruar shtesa krahas pagave të tyre.

Ngjashëm sikurse kolegët e tyre në KGJK, edhe një pjesë e anëtarëve të KPK-së, të hyrat e tyre nuk i kanë deklaruar ashtu siç e kërkon ligji për deklarimin e pasurisë, pra, të ndara sipas llojit, shumës e burimit të tyre. Në vijim është paraqitur analiza për anëtarë e ish-anëtarë të KPK-së.

i. Jetish Maloku

Kryesuesi i KPK-së, Jetish Maloku, në deklarimin e tij të pasurisë në vitin 2020, kishte theksuar se përveç pozitës së kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjilan, të cilën e kishte pasur atëkohë, kishte qenë njëkohësisht edhe trajnues në Akademinë e Drejtësisë. Si pagë mujore, z. Maloku kishte deklaruar shumën në lartësi prej 2,369.00 euro, që brenda vitit i bie se ka realizuar pagë vjetore prej 28,428.00 euro.

Si të ardhura të tjera, nga mëditjet, trajnimet dhe aktivitete të tjera, z. Maloku kishte deklaruar 1,558.00 euro, porse, për këto të ardhura nuk e ka cekur fare burimin e tyre pavarësisht se një gjë e tillë kërkohet me Ligjin për Deklarimin e Pasurisë. Si të ardhura totale, z. Maloku kishte deklaruar, 29,986.00 euro. Sa i përket të ardhurave nga Akademia e Drejtësisë, z. Maloku ka thënë se i ka realizuar duke u bazuar në ligjet përkatëse për Akademinë e Drejtësisë, Prokurorin e Shtetit dhe KPK-në. Kurse, mëditje tjera, z. Maloku thotë se i ka realizuar nga detyrat zyrtare duke u bazuar në udhëzimin administrativ nr. MSHP 2004/07 për udhëtimet zyrtare dhe në bazë të vendimit të Ministrisë së Financave nr. 30/2018. Realizimi i këtyre shtesave, sipas z. Maloku, nuk bie ndesh me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, pasi siç thuhet në përgjigjen e tij për IKD, ai nuk kishte ushtruar ndonjë funksion tjetër përveç atij të kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjiilan.³⁴ Megjithatë, z. Maloku dështon të përmend në përgjigjen e tij, se pikërisht Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit ndalon shprehimisht shpërblimet me pagesë për detyra tjera jashtë pozitës bazë që mban zyrtar i lartë, ndërsa nga deklarimi i pasurisë dhe nga vet përgjigja e z. Maloku, del se i njëjti, krahas pagës bazë, ka realizuar mbi 1,500.00 euro vetëm nga Akademia e

Drejtësisë, të ardhura këto që nuk kanë pasur të bëjnë me kompensime për udhëtime dhe shpenzime të lidhur me to.

ii. Aleksandër Lumezi

Sipas deklarimit të pasurisë që z. Lumezi ka bërë në vitin 2020, del se i njëjti përveç pozitës së Kryeprokurorit të Shtetit, gjatë vitit të kaluar ka mbajtur edhe dy (2) pozita drejtuese, përkatësisht pozitën e Kryetarit të Bordit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë deri në shtator 2020 dhe pozitën e Kryetarit të Komisionit për Dhënien e Provimit të Jurisprudencës deri në mars 2020.

Sipas nenit 13 (2) të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, "*zyrtarit të lartë i ndalohet të jetë drejtues i më shumë se një organi drejtues të një institucioni publik përveç nëse parashihet ndryshe shprehimisht me ligj*". Kryeprokurori i Shtetit në asnjërin prej dy pozitave të tjera drejtuese, nuk i përcaktohet me ligj se duhet të jetë drejtues i institucionit. Prandaj, ushtrimi i këtyre pozitave drejtuese konsumonte veprën penale të konfliktit të interesit, gjë që do duhej të ndiqej pikërisht nga Prokurori i Shtetit.

Po ashtu, i njëjti sipas detyrës zyrtare vazhdon të mbajë ende pozitat e anëtarit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, anëtarit të bordit në

³⁴ Përgjigje përmes adresës elektronike e z. Maloku për IKD. 17 mars 2021.

Akademinë Policore të Kosovës, anëtar i Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë dhe anëtar i Bordit të Inteligjencës Financiare

Për këto pozita të cilat i mban, z. Lumezi, ka deklaruar të ardhura vjetore shumë prej 41,285.00 euro, paçka se në deklarin e tij të pasurisë nuk i ka ndarë të ardhurat veç e veç për secilën pozitë, ashtu siç kërkohet me ligj. Krahas këtyre të ardhurave, Lumezi ka deklaruar edhe 1,404 euro nga mëditjet, ushqimi, akomodim dhe udhëtime zyrtare. Si total, Lumezi ka deklaruar 42,689.00 euro.

iii. Bahri Hyseni

Ish-kryesuesi Bahri Hyseni kishte qenë pjesë e KPK-së deri në fund të dhjetorit 2020. Përveç kësaj pozite, i njëjti nuk ka deklaruar se ka pasur edhe ndonjë pozitë tjetër, ndonëse në deklarin e tij të të hyrave, figuron se ka realizuar edhe 1,368.00 euro nga shërbimet e trajnimit në Akademinë e Drejtësisë.

Si të hyra nga paga, z. Hyseni ka deklaruar 33,268.89 euro, kurse mëditje nga KPK, i njëjti ka deklaruar 967.35 euro. Këto mëditje, z. Hyseni ka deklaruar se i ka pranuar nga KPK, por nuk ka theksuar për çfarë lloj pune apo shërbimi i ka realizuar. Në këtë rast, Ligji për KPK, përcakton se kryesuesi gjatë mandatit të tij pranon vetëm

pagën e përcaktuar me ligj, si dhe ndonjë rimbursim të arsyeshëm që ndërlidhet me detyra të tij të përcaktuar me ligj, porse, realizimi i rreth 1,000 eurove si mëditje është vështirë i shpjegueshëm si rimbursim i arsyeshëm siç përcaktohet me ligj. Si pagesa për shpenzime të cilat nuk i ka specifikuar se çfarë kanë qenë, z. Hyseni i ka deklaruar 1,457.63 euro, kurse burimin e tyre e ka cekur se ka qenë "Amerikane, Austri, Itali". 168 euro të tjera, prokurori Hyseni i kishte deklaruar si paga nga viti paraprak nga Kolegji "Juridica". Totali i të hyrave vjetore të cilat i ka deklaruar z. Hyseni del të jetë 37,228.00 euro. Në shkurt të këtij viti, kryeprokurori i shtetit, Aleksandër Lumezi, në mënyrë të kundërligjshme e kishte avancuar në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, z. Hyseni.³⁵

Lidhur me funksionet që kishte mbajtur, z. Hyseni, në një përgjigje për IKD ka thënë se me zgjedhjen në krye të KPK-së ishte dorëhequr nga pozita e ligjëruesit në një kolegji privat si dhe nga Komisioni për Kompensimin e Viktimave. Sa i përket mëditjeve që kishte marrë nga KPK, z. Hyseni thekson në përgjigjen e tij se të njëjtat janë realizuar sipas legjislacionit në fuqi, ku citon ndër të tjera Ligjin për Këshillin Prokurorial të Kosovës. Sa i

³⁵ Shih për më tepër, Bajraktari, L. "Ligjshmëria e avancimeve dhe përfitimeve në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit". IKD. Shkurt 2021. Prishtinë. (Shih linkun: <https://kli->

[ks.org/ligjshmeria-e-avancimeve-dhe-perfitimeve-ne-zyren-e-kryeprokurorit-te-shtetit/](https://kli-ks.org/ligjshmeria-e-avancimeve-dhe-perfitimeve-ne-zyren-e-kryeprokurorit-te-shtetit/)). Qasur për herën e fundit më 8 mars 2021.

përket të hyrave nga Akademia e Drejtësisë, z.Hyseni thotë se i ka realizuar nga puna e tij si trajnues i përkohshëm, gjë të cilën thekson se ia lejon edhe Ligji për KPK, gjegjësit neni 18.5 i cili përcakton se “Kryesuesi, zëvendëskryesuesi dhe anëtarët prokurorë të Këshillit nuk kanë të drejtë të ushtrojnë ndonjë detyrë tjetër publike apo profesionale për të cilën shpërblehen me pagesë, përveç mësimdhënies në institucionet e arsimit të lartë, Akademisë së Drejtësisë apo rasteve të parapara me ligj.”³⁶

iv. Merita Bina-Rugova

Prokurorja nga radhët e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK), Merita Bina-Rugova, në deklarin e saj të pasurisë të bërë në vitin 2020, kishte deklaruar se përveç pozitës së prokurores speciale është edhe trajnuese në Akademinë e Drejtësisë. Por, ndonëse në mars të vitit 2019 ishte betuar si anëtare e KPK-së, e njëjta nuk e ka deklaruar këtë pozitë në deklarin e saj të pasurisë. Si pagë nga PSRK, znj. Bina-Rugova kishte deklaruar 31,300.00 euro, kurse, 4,800 euro të tjera i kishte deklaruar si shtesa, gjithashtu nga PSRK. Ndërsa, si kompensim nga KPK, prokurorja kishte deklaruar 2,630.00 euro kurse si kompensim nga Akademia e Drejtësisë, kishte deklaruar 384 euro. Në total, znj.

Bina-Rugova kishte deklaruar 39,114.00 euro të ardhura vjetore.

Lidhur me të hyrat shtesë, prokurorja Bina në një përgjigje për IKD thekson se shumë prej 2,630.00 euro i ka realizuar si anëtare e KPK-së bazuar në nenin 18.2 të Ligjit për KPK-në, kurse të ardhurat nga Akademia e Drejtësisë thekson se i ka realizuar nga puna e saj si trajnuese e përkohshme në këtë institucion, gjë të cilën thotë se ia lejon edhe Ligji për KPK, përkatësisht neni 18.5.³⁷ Realizimin e këtyre shtesave, prokurorja Bina nuk e konsideron se bie ndesh me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, pavarësisht se ky i fundit e ka ndaluar realizimin e shpërblimeve me pagesë për zyrtarët e lartë për angazhimin e tyre në detyra tjera, përjashtimisht kompensimeve për udhëtime dhe shpenzime tjera të lidhura me të. Nga përgjigjet e znj. Bina, del se shtesat të cilat i kishte realizuar nuk janë kompensime të parapara me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

v. Bedrije Sylja-Alshiqi

Prokurorja Bedrie Sylja-Alshiqi, në deklarin e saj të pasurisë, kishte deklaruar të ardhura nga paga shumë prej 30,526.65 euro. Si burim i kësaj page, znj. Sylja-Alshiqi kishte cekur Prokurorinë e Apelit. Kurse, 1,006.58 euro të tjera, prokurorja Sylja-Alshiqi i kishte deklaruar si mëditje nga

³⁶ Përgjigje përmes adresës elektronike e z. Hyseni për IKD. 12 mars 2021.

³⁷ Përgjigje përmes adresës elektronike e znj. Bina për IKD. 12 mars 2021.

udhëtimet zyrtare pa cekur se cili kishte qenë burimi i këtyre të ardhurave. Si total, znj. Sylja-Alshiqi kishte deklaruar 31,532.00 euro të ardhura. Gjithashtu, prokurorja Sylja-Alshiqi nuk kishte potencuar në deklarimin e saj edhe funksionin që mban si anëtare e KPK-së.

vi. Arben Ismajli

Prokurori Arben Ismajli kishte qenë pjesë e KPK-së deri në dhjetor 2020, ku kishte mbajtur edhe pozitën e zëvendës-kryesuesit. Pavarësisht kësaj, i njëjti në deklarimin e tij të pasurisë ka deklaruar vetëm pozitën e prokurorit. Z. Ismajli, në tetor 2020, pak para se t'i mbaronte mandati i tij në KPK, kishte dhënë dorëheqje nga kjo pozitë. Po të njëjtën ditë, KPK kishte shpallur konkurset për kryeprokurorë të disa prokurorive. Ndaj dorëheqjes së tij dhe dy anëtarëve të tjera kishin reaguar, IKD, Ambasada Amerikane dhe Zyra e BE-së. Sipas IKD-së, nëse do vërtetoheshin pretendimet se z. Ismajli është dorëhequr për të kandiduar për kryeprokuror, atëherë një veprim i tillë do të ishte në kundërshtim me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.³⁸ Pas këtyre reagimeve, z. Ismajli kishte revokuar dorëheqjen e tij. Ndryshe, në deklarimin e tij të pasurisë, z. Ismajli kishte deklaruar si të ardhura

nga paga 29,374.00 euro. Si shtesa tjera krahas pagës, prokurori Ismajli kishte deklaruar 717 euro nga mëditjet dhe shpenzimet për mbushje të telefonit nga KPK si dhe 250 euro të tjera nga angazhimi i tij si ekspert nga KPK-ja. Si shpenzime nga vizitat zyrtare, z. Ismajli kishte deklaruar 1,689.00 euro, ku si burim i të hyrave figuron UNDP. Totali i të hyrave që z. Ismajli ka deklaruar, arrijnë vlerën prej 32,030.00 euro.

vii. Dëshirë Jusaj

Prokurorja Dëshirë Jusaj, në deklarimin e saj të pasurisë të bërë në vitin 2020, kishte deklaruar se përveç pozitës së prokurores mban edhe pozitën e anëtares në KPK si dhe është mentore në Akademinë e Drejtësisë.

Në deklarimin e të ardhurave të saj, znj. Jusaj ka deklaruar 1,775.25 euro si pagë mujore apo 21,303.00 euro të ardhura vjetore. Po ashtu, e njëjta ka deklaruar edhe në dy rubrika të tjera, të ardhura të cilat i ka cilësuar si paga mujore, njëra në shumë prej 262 euro dhe tjetra, në shumë prej 85 euro. Burimin e tyre, prokurorja e ka cekur se është Buxheti i Kosovës, pa specifikuar se nga cila pozitë i kishte realizuar këto paga. Lidhur me këto të ardhura, në një përgjigje për IKD, prokurorja Jusaj

³⁸ Shih reagimin e IKD-së: "IKD: Dorëheqja e anëtarëve të KPK-së në kohën para shpalljes së konkursit për kryeprokurorë, praktikë që mund të paraqesë konflikt të interesit dhe mungesë të integritetit". Tetor 2020. (Shih linkun: <https://kli-ks.org/ikd-doreheqja-e-anetareve->

[te-kpk-se-ne-kohen-para-shpalljes-se-konkursit-per-kryeprokurore-praktike-qe-mund-te-paraqese-konflikt-te-interesit-dhe-mungese-te-integritetit/](https://kli-ks.org/ikd-doreheqja-e-anetareve-te-kpk-se-ne-kohen-para-shpalljes-se-konkursit-per-kryeprokurore-praktike-qe-mund-te-paraqese-konflikt-te-interesit-dhe-mungese-te-integritetit/)). Qasur për herën e fundit më 8 mars 2021.

thekson se të ardhurat prej 265 euro janë të ardhura mujore të cilat i realizon si anëtare e KPK-së, ndërsa thotë se realizon gjithashtu nga 85 euro të ardhura mujore nga Akademia e Drejtësisë, në cilësi të mentores në Akademinë e Drejtësisë. Për këto të hyra shtesë, znj. Jusaj thekson se nuk bien ndesh me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, pasi nuk e tejkalon 25% e pagës bazë, edhe pse kufiri prej 25% është i përcaktuar me Ligjin për KPK e jo me ligjin e cituar nga prokurorja.³⁹ Porse, prokurorja dështon të përmend faktin se Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit ndalon shpërblimet me pagesë krahas pagës bazë, për detyra tjera që zyrtarët e lartë ushtrojnë. Ndërsa, sipas përgjigjes së prokurores, del se të ardhurat nga KPK dhe Akademia, nuk janë kompensime siç e parasheh Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Prokurorja Jusaj, në tetor 2020, pak para se t'i mbaronte mandati si anëtare në KPK, kishte dhënë dorëheqje nga kjo pozitë dhe kishte kandiduar për kryeprokurore të Prokurorisë Themelore në Gjakovë. Një gjë të tillë e kishte bërë ndonjë Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, ia

ndalon një gjë të tillë në të paktën dy (2) vite pas përfundimit të mandatit të saj në KPK. Pas dështimit herën e parë, prokurorja Jusaj kishte kandiduar sërish në konkursin e ri-shpallur për kryeprokurore të Gjakovës, me ç'rast, KPK në mbledhjen e mbajtur më 26 mars 2021, e kishte konfirmuar kandidaturën e saj.⁴⁰ Për këtë kandidim të saj, znj. Jusaj konsideron nuk është në kundërshtim me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit⁴¹, porse, nuk jep ndonjë shpjegim lidhur me mos përfilljen e ndalesës dy vjeçare të përcaktuar me neni 18 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit. Lidhur me këtë, vlejné të njëjtat argumente që kemi dhënë tek gjyqtari Armend Berisha, si dhe reagimi i cituar tek rasti i prokurorit Arben Ismajli.

viii. Haxhi Sinanaj

Prokurori Haxhi Sinanaj, kishte deklaruar se përveç pozitës së prokurorit ka qenë edhe anëtar i KPK-së, pozitë të cilën e kishte mbajtur deri më 31 dhjetor 2020. Si pagë vjetore, z. Sinanaj kishte deklaruar 26,030.25 euro. Shtesa tjera krahas pagës, prokurori Sinanaj kishte deklaruar dhe 3,156.00 euro si anëtar i KPK-së. Këto të hyra shtesë, prokurori Sinanaj thotë se nuk bien ndesh me Ligjin për Parandalimin

³⁹ Përgjigje përmes adresës elektronike e znj. Jusaj për IKD. 12 mars 2021.

⁴⁰ "IKD: KPK në kundërshtim me ligjin nominali kandidaturën e ish-anëtares së KPK-së për kryeprokurore të PTh në Gjakovë". Betimi për Drejtësi". 6 prill 2021. (Shih linkun: [https://betimiperdrejtesi.com/ikd-kpk-ne-](https://betimiperdrejtesi.com/ikd-kpk-ne-kundershtim-me-ligjin-nominali-kandidaturen-e-ish-anetares-se-kpk-se-per-kryeprokurore-te-ptth-ne-gjakove/)

[kundershtim-me-ligjin-nominali-kandidaturen-e-ish-anetares-se-kpk-se-per-kryeprokurore-te-ptth-ne-gjakove/](https://betimiperdrejtesi.com/ikd-kpk-ne-kundershtim-me-ligjin-nominali-kandidaturen-e-ish-anetares-se-kpk-se-per-kryeprokurore-te-ptth-ne-gjakove/)). Qasur për herën e fundit më 26 mars 2021.

⁴¹ Përgjigje përmes adresës elektronike e znj. Jusaj për IKD. 12 mars 2021.

e Konfliktit të Interesit, pasi prokurori thotë se të ardhurat i ka realizuar duke u bazuar në nenin 18.2 të Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës i cili parasheh se anëtarët e Këshillit me orar jo të plotë kanë të drejtë në kompensim për punën e tyre si anëtarë të Këshillit.⁴²

ix. Ikramije Bojaxhiu

Prokurorja Ikramije Bojaxhiu, e cila kishte qenë anëtare e KPK-së deri në dhjetor 2020, kishte deklaruar se pozitë tjetër të cilën e kishte ushtruar është ajo e trajnueses në Akademinë e Drejtësisë.

Tek të hyrat e saj, znj. Bojaxhiu kishte deklaruar nga pagat shumë prej 28,868.64 euro. Si shtesa tjera krahas pagës, znj. Bojaxhiu kishte deklaruar 1,180.25 euro si mëditje për udhëtime zyrtare nga KPK kurse si mëditje të njëjta, por ku burim të tyre ka deklaruar partnerët ndërkombëtar, znj. Bojaxhiu ka deklaruar edhe 1,428.00 euro. Nga shërbimet e trajnimit në Akademinë e Drejtësisë, prokurorja Bojaxhiu ka deklaruar 1,026.00 euro. Totali i të hyrave që znj. Bojaxhiu kishte deklaruar arrin vlerën prej 32,502.00 euro.

x. Ardian Hajradaj

Prokurori Ardian Hajdaraj, ishte zgjedhur si anëtar i KPK-së në tetor të vitit 2020. Në deklarimin e tij të pasurisë, që e kishte bërë në mars të vitit 2020, z. Hajdaraj kishte deklaruar

përveç pozitës së prokurorit, se ka qenë edhe anëtar i një komisioni në KPK, ekspert për zhvillimin e programit SMIL si dhe ligjërues në Akademinë e Drejtësisë.

Si pagë mujore, z. Hajdaraj ka deklaruar të ardhura prej 2,030.09 euro, apo 24,361.08 euro pagë brenda vitit. 513 euro të tjera, prokurori Hajdaraj i kishte deklaruar nga shërbimet e trajnimit në Akademinë e Drejtësisë, 291 euro të tjera si mëditje nga KPK, dhe 250 euro kompensim për punën në Komisionin për SMIL, ku si burim i këtyre të ardhurave të fundit, figuron një donacion nga shteti i Norvegjisë. Si total, z. Hajdaraj kishte deklaruar 25,415.08 euro të ardhura.

xi. Radica Milic

Prokurorja Radica Milic, në deklarimin e saj të pasurisë ka deklaruar se përveç pozitës së prokurores dhe anëtares në KPK, nuk mban ndonjë pozitë tjetër. Pozitën në KPK, prokurorja e kishte mbajtur deri në dhjetor 2020. Si të ardhura personale nga KPK, znj. Milic ka deklaruar 2,462.00 euro apo 29,544.00 euro të ardhura vjetore, kurse si shtesa nga KPK, e njëjta ka deklaruar 276 euro. Totali i të hyrave të cilat i ka deklaruar prokurorja Milic, kap shumë prej 29,820.00 euro.

⁴² Përgjigje përmes adresës elektronike e z. Sinanaj për IKD. 16 mars 2021.

xii. Zejnullah Gashi

Prokurori Zejnullah Gashi në deklarin e tij të pasurisë kishte deklaruar se ka ushtruar vetëm pozitën e anëtarit në KPK. Në Këshill, z. Gashi kishte qenë kryesues i Komisionit për Çështje Normative, pra anëtar me orar të plotë, të cilën pozitë e kishte mbajtur deri në fund të vitit 2020. Si pagë, z. Gashi ka deklaruar 28,329.00 euro të ardhura. Kurse, si shtesa, mëditje e trajnime, prokurori Gashi nga KPK dhe institucione të tjera, kishte deklaruar 1,590.00 euro. Këto të hyra shtesë, prokurori Gashi nuk i ka ndarë sipas shumës, llojit dhe burimit të tyre veç e veç porse të njëjtat i ka deklaruar të gjitha bashkë. Në një përgjigje për IKD, prokurori Gashi thotë se do të kërkojë nga Departamenti i Financave i KPK-së që këto të hyrë t'i ndajë sipas kategorive.⁴³ Total i të ardhurave që kishte deklaruar z. Gashi kishte qenë 29,919.00 euro.

xiii. Veton Shabani

Zëvendës-kryesuesi i KPK-së, Veton Shabani, në kohën kur kishte deklaruar pasurinë e tij, kishte potencuar se brenda vitit, kishte realizuar 25,322.95 euro të ardhura, nga paga si prokuror dhe nga kompensimet si anëtar i Komisionit për Administrimin e Prokurorive. Këto të ardhura, z. Shabani nuk i kishte ndarë sipas llojit të

tyre veç e veç, por i kishte paraqitur të dy këto të ardhura së bashku.

xiv. Agron Beka

Anëtari i KPK-së nga radhët e profesorëve të fakulteteve juridike, Agron Beka, në deklarin e tij të pasurisë në vitin 2020, kishte deklaruar se mban pozitën e ushtruesit të detyrës në Universitetin "Isa Boletini" në Mitrovicë si dhe atë të profesorit në Kolegjin Evropian "Juridica". Si të hyra nga Universitetit "Isa Boletini", z. Beka kishte deklaruar pagë prej 23,498.76 euro, kurse, nga pozita e tjetër në Kolegjin "Juridica", nuk kishte deklaruar ndonjë të hyrë. Në KPK, z. Beka ishte zgjedhur në gusht të vitit 2020.

xv. Arjana Shajkovci

E zgjedhur si prokurore nga viti 2008, prokurorja Arjana Shajkovci ishte zgjedhur edhe anëtare e KPK-së në tetor të vitit 2020. Në deklarin e saj të pasurisë të bërë në mars të vitit 2020, znj. Shajkovci kishte deklaruar të ardhura vjetore nga paga në lartësi prej 24,018.00 euro ndërsa atë kohë, nuk kishte deklaruar se mban ndonjë pozitë tjetër përveç asaj të prokurores.

xvi. Armend Zenelaj

Anëtar tjetër i KPK-së që ishte zgjedhur në tetor të vitit 2020, është prokurori Armend Zenelaj. I njëjti, në deklarin e tij të pasurisë të bërë në mars të vitit 2020, kishte theksuar se nuk mban

⁴³ Përgjigje përmes adresës elektronik e z. Gashi për IKD. 11 mars 2021.

ndonjë pozitë tjetër përveç asaj të prokurorit, kurse, të ardhurat e vetme që kishte deklaruar kishin qenë ato nga paga e prokurorit në shumë prej 1,739.00 euro, apo përkthyer në pagë vjetore i bie që prokurori Zenelaj ka pranuar 20,868.00 euro.

xvii. Jehona Grantolli

Në deklarin e saj të pasurisë në vitin 2020, prokurorja Jehona Grantolli, kishte theksuar se nuk ka ndonjë pozitë tjetër përveç asaj të prokurores kurse, si të ardhura mujore kishte deklaruar shumë prej 1,670.00 euro, apo të ardhura vjetore prej 20,040.00 euro. E njëjta ishte zgjedhur anëtare e KPK-së, në tetor 2020.

xviii. Jovo Radovic

Në tetor 2020, anëtar i KPK-së ishte zgjedhur edhe prokurori Jovo Radovic. Në deklarin e tij të pasurisë, të bërë në prill të vitit 2020, i njëjti kishte deklaruar se nuk ka ndonjë pozitë tjetër përveç asaj si prokuror, kurse, si të ardhura vjetore, i njëjti kishte deklaruar 22,800.00 euro.

xix. Lavdim Krasniqi

Drejtori i Sekretariatit në KPK, Lavdim Krasniqi, kishte deklaruar në vitin 2020, se përveç pozitës së Drejtorit në KPK, mban edhe pozitën e profesorit në Kolegjin "UBT" si dhe atë të arbitrit në

Tribunalin e Arbitrazhit në kuadër të Odës së Avokatëve të Kosovës. I njëjti kishte deklaruar të ardhura nga paga e tij si drejtor në KPK, shumë prej 25,420.67 euro, kurse si të ardhura nga paga sekondare në Kolegjin "UBT", kishte deklaruar 700 euro. 1,361.70 euro të tjera, z. Krasniqi i kishte deklaruar si pagesa nga shërbimet profesionale në Akademinë e Drejtësisë, ndërsa 1,354.50 euro i kishte deklaruar si të

rdhura nga mëditjet prej KPK-së dhe donatorëve. Si pagesa për shërbime profesionale nga Oda e Avokatëve të Kosovës, z. Krasniqi i kishte deklaruar 3,510.33 euro ndërsa 200 euro të tjera nga "International Managment Group". Në total, z. Krasniqi kishte deklaruar 32,545.00 euro të ardhura. I njëjti ishte pezulluar nga pozita e tij në KPK, në mars 2020, pasi ishte arrestuar nën dyshimet për korrupsion.⁴⁴

⁴⁴ "Lavdim Krasniqi suspendohet nga detyra e drejtorit të përgjithshëm të Sekretariatit të KPK-së". Betimi për Drejtësi. 2 mars 2021. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/lavdim->

[krasniqi-suspendohet-nga-detyra-e-drejtorit-te-pergjithshem-te-sekretariatit-te-kpk-se/](https://betimiperdrejtesi.com/lavdim-krasniqi-suspendohet-nga-detyra-e-drejtorit-te-pergjithshem-te-sekretariatit-te-kpk-se/)). Qasur për herën e fundit më 9 mars 2021.

PAGAT DHE KOMPENSIMET E ANËTARËVE TË KËSHILLIT GJYQËSOR

Gjykatësit	Paga bazë sipas ligjit	Paga e deklaruar	Shtesat e deklaruar	Veprimtaritë profesionale	Totali vjetor i të hyrave	Deklarimi sipas ligjit
 Albert ZOGAJ	28,668 ¹ €	26,303 €	6,935 €	5,472 €	38,710 €	X
 Skender Çoçaj	35,400 €	31,492 €	4,117 €	2,765 €	38,434 €	✓
 Nehat Idrizi	28,668 ² €	35,738 €	609 €	- €	36,348 €	✓
 Nenad Lazic	28,668 €	29,762 €	5,422 €	- €	35,184 €	✓
 Driton Muharremi	28,668 ³ €	27,923 €	69 €	6,702 €	34,694 €	X
 Anita Krasniqi-Prenaj	31,860 ⁴ €	29,347 €	- €	- €	29,347 €	X
 Armend Berisha	31,860 ⁵ €	27,605 €	485.20 €	- €	28,090 €	X
 Qerim Ademaj	28,668 €	26,492 €	707 €	- €	27,199 €	✓

SHUMË GJYKATËS NUK E KANË DEKLARUAR PAGËN BAZË DHE TË HYRAT E TJERA SIPAS OBLIGIMIT LIGJOR.

"Gjyqtarët, për aktivitetet e parapara në këtë nen pranojnë shpërblim, i cili nuk mund të tejkalojë vlerën prej njëzetepesë (25%) për qind të pagës bazë, dhe për këtë shpërblim Gjyqtarët e njoftojnë Kryetarin e Gjykatës kurse Kryetarët e Gjykatave e njoftojnë Këshillin."

LIGJI PËR GJYKATAT

"Zyrtari i lartë, në cilësinë e anëtarit të organeve të përmendura në këtë paragraf, nuk ka të drejtë shpërblimi me pagesë, përveç të drejtës në kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimeve të tjera të lidhura me të."

LIGJI PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESIT

1 - Gjyqtari Zogaj nuk ka deklaruar të ardhurat veç e veç, por brenda një kolone ka deklaruar së bashku të ardhurat nga disa burime të ndryshme. Në vitin 2019, Zogaj kishte qenë gjyqtar në Apel dhe paga bazë e tij kishte qenë 28,668 euro.

2 - Idrizi kishte qenë kryesues i KGJK-së deri në mars 2019, me c'rast kishte pasur pagë bazë 2,950.00. Pas kësaj datë, i njëjti ka realizuar pagën e gjyqtarit të Apelit.

3 - Gjyqtari Muharremi nuk ka deklaruar të ardhurat nga paga dhe kompensime veç e veç, por brenda një kolone ka deklaruar së bashku të ardhurat nga paga dhe kompensimet tjera.

4 - Gjyqtarja Krasniqi ka deklaruar të hyrat nga paga dhe meditet tjera nga KGJK, Akademia e Drejtësisë së bashku, pa i ndarë ato veç e veç. Paga bazë e gjyqtarës Krasniqi është ajo si anëtare me orar të plotë në KGJK.

5 - Gjyqtari Berisha nuk i ka deklaruar të ardhurat nga paga dhe kompensime veç e veç, por brenda një kolone ka deklaruar së bashku të ardhurat nga paga dhe kompensimet tjera. Paga bazë e gjyqtarit është llogaritur ajo si anëtar me orar të plotë në KGJK.

PAGAT DHE KOMPENSIMET E ANËTARËVE TË KËSHILLIT PROKURORIAL

Prokurorët	Paga bazë sipas ligjit	Paga e deklaruar	Shtesat e deklaruar	Veprimtaritë profesionale	Totali vjetor i të hyrave	Deklarimi sipas ligjit
 Aleksander Lumnezi	35,400 ¹ €	41,285 €	1,404 €	- €	42.689 €	
 Merita-Bina-Rugova	31,860 €	31,300 €	7,814 €	- €	39,114 €	
 Bahri Hyseni	35,400 ² €	33,268 €	2,335 €	1,625 €	37,228 €	
 Lavdim Krasniqi	25,420 ³ €	25,420 €	2,715 €	4,410 €	32,545 €	
 Ikramije Bojaxhiu	31,860 ⁴ €	28,868 €	3,634 €	- €	32,502 €	
 Arben Ismaili	31,860 ⁵ €	29,374 €	717 €	1,939 €	32,030 €	
 Bedrije-Syla-Alshiqi	28,668 €	30,526 €	1,006 €	- €	31,532 €	
 Zejnullah Gashi	31,860 €	28,329 €	1,590 €	- €	29,919 €	
 Jetish Maloku	28,668 ⁶ €	28,428 €	1,559 €	- €	29,986 €	
 Haxhi Sinani	20,064 ⁷ €	26,030 €	3,156 €	- €	29,186 €	
 Dëshirë Jusaj	20,064 €	21,303 €	4,164 €	- €	25,467 €	

"Prokurorët dhe Kryeprokurorët, për aktivitetet e parapara, në këtë nen pranojnë shpërbllim, i cili nuk mund të tejkalojë vlerën prej njëzetepesë (25%) përqind të pagës bazë, dhe për këtë shpërbllim prokurorët e njoftojnë Kryeprokurorin, kurse Kryeprokurorët e njoftojnë Këshillin". LIGJI PËR PROKURORIN E SHTETIT

"Zyrtari i lartë, në cilësinë e anëtarit të organeve të përmendura në këtë paragraf, nuk ka të drejtë shpërbllimi me pagesë, përveç të drejtës në kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimeve të tjera të lidhura me të." LIGJI PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESIT

1 - Kryeprokurori Lumezi ka deklaruar të hyrat nga paga dhe medijtjet tjera nga KPK, Akademia e Drejtësisë së bashku, pa i ndarë ato veç e veç.
 2 - Paga bazë e prokurorës Bojaxhiu është llogaritur ajo si anëtare me orar të plotë në KPK.
 3 - Lavdim Krasniqi është Drejtor i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial.
 4 - Paga bazë e prokurorit Ismaili është llogaritur ajo si zv.kryesues në KPK. Prokurori Ismaili nuk i ka ndarë të gjitha të hyrat shtesë, sipas shumës, llojit dhe burimit vec e vec.
 5 - Paga bazë e prokurorit Jetishi është llogaritur ajo që e ka pasur në vitin 2019, si kryeprokuror i PTH Gjilan. Jetishi nuk kishte deklaruar burimin e të hyrave shtesë.
 6 - Paga bazë e prokurorit Gashi është llogaritur ajo si anëtar me orar të plotë në KPK. Prokurori Gashi nuk i kishte ndarë të hyrat shtesë sipas shumës, llojit dhe burimit veç e veç.
 7 - Paga bazë e prokurorit Sinanaj është llogaritur si paga bazë e prokurorit në shkallë të parë.
 Duke qenë prokuror i krimeve të rënda, paga e prokurorit Sinanaj mund të shkojë deri në 90% të pagës së kryeprokurorit apo 28,500.00 euro në vit.

10. Rekomandime

- ❖ Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës, në pajtim me obligimet që dalin nga Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, të sigurohen që gjyqtarët dhe prokurorët të mos marrin kompensime shtesë gjatë orarit të punës, dhe në raste kur kjo nuk zbatohet mekanizmat e sistemit gjyqësor dhe prokurorial të iniciojnë procedura disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve;
- ❖ Anëtarët e KGJK-së dhe KPK-së, të mos marrin shpërblime shtesë për punët që kryejnë gjatë orarit të rregullt të punës përveç kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimeve të tjera që lidhen me të;
- ❖ KGJK dhe KPK, të bëjnë plotësim/ndryshimet në legjislacionin e tyre sekondar ashtu që të ndalojnë pagesat shtesë për angazhimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në komisione gjatë orarit të rregullt të punës, në mënyrë që të harmonizohen këto rregulla të brendshme me kornizën ligjore e kushtetuese në Kosovë;
- ❖ Agjencia Kundër Korrupsion në mënyrë proaktive të zbatojë mandatin ligjor në inicimin e

procedurave ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve që shkelin Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik;

- ❖ Agjencia Kundër Korrupsion të mos pranojë si të rregullta formularët për deklarim të pasurisë që nuk janë konform Ligjit për Deklarimin e Pasurisë;
- ❖ Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësi të tyre të mbaj llogaridhënës AKK-në, lidhur me zbatimin e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.